

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6017  
E enjte, 5 mars 2020  
çmimi 0.40 €

Sot shënohet  
22-vjetori i  
"Epopesë së UÇK-së"

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PAS VIZITËS ZYRTARE NË SHETETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA),  
PRESIDENTI HASHIM THAÇI KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

## THAÇI: SHBA-ja ËSHTË RIKTHYER FUQISHËM NË DIALOGUN KOSOVË - SERBI



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën ka bërë me dije se takimi në Uashington, me presidentin e Serbisë, paraqet çast kthese në dialogun ndërmjet dy vendeve me leadershipin e Shteteve

të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Thaçi ka pohuar se Kosova duhet ta shfrytëzojë momentumin historik pasi është një rol dhe interesim në rritje nga ShBA-ja dhe presidenti Donald Trump që të përmbillet ky proces me marrëveshje

paqësore. Presidenti Thaçi ka kërkuar edhe unitet politik në Kosovë, ngjashëm me proceset e kaluara negociatore, në mënyrë që çështjet në dialogun me Serbinë t'i përmbillet me një unitet të brendshëm politik

FLET PËR "EPOKËN E RE", FERAT SHALA

## Kosova po përkeqëson raportet me ndërkombëtarët për shkak të taksës

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se koalicionin qeverisës LV - LDK ende nuk ka prezantuar program qeveritar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Shala ka theksuar se

ky koalicion qeverisës nuk ka koordinim as për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Ai ka thënë se për shkak të lojës me taksën kemi edhe përkeqësim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë.



### OPINION

AKADEMIA  
MBARËKOMBËTARE E  
SHKENCAVE DHE E ARTEVE  
QË DUHET TA KEMI F. 7

Rexhep  
QOSJA



TAKSA PLUS  
RECIPROCITETI F. 8

Nga Jakup  
KRASNIQI



### AKTUALE

SHTOHEN VEPRIMET PËR  
PARANDALIMIN E NARKOTIKËVE  
NË BURGUN E DUBRAVËS F. 6

### EKONOMI

BUXHETI PËR VITIN 2020,  
ENDE NË FAZËN  
E HARMONIZIMIT F. 9

KONTRABANDA NË VERI,  
KAPËN MBI 8 500 LITRA PIJE  
JOALKOOLIKE F. 9

### KULTURË

DUMOSHI PRET NË TAKIM  
MINXHOZIN, DISKUTOJNË PËR  
BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E  
KULTURËS F. 18

### SPORT

BALLKANI 'FIK' DRITËN,  
GJILANI DHE PRISHTINA  
KUNDËRPËRGJIGJEN ME FITORE

F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta kthen në Kuvend Ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

TIRANË, 4 MARS - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta kthen në Kuvend Ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në njoftim thuhet se Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 12 shkurt 2020, ka miratuar ndër të tjera dhe ligjin nr. 15/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Ky ligj me shkresën me nr. 664 protokoll, datë 14.02.2020 të Kuvendit, i është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje. "Sipas dokumentacionit parlamentar rezulton se projektligji i paraqitur Kuvendit për



shqyrtim është iniciuar nga një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të njëjtët deputetë të mazhorancës (Adnor Shameti, Alket Hyseni dhe Edmond Leka) që kanë propozuar edhe nismën antikushtetuese që ka marrë numër ligji 14/2020 "Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë

10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të praktikës parlamentare (relacionit shoqërues të projektligjit, Raportit të Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut), edhe ky ligj

synon ndryshimin e rregulimeve ligjore për kryerjen e ceremonisë publike të betimit, si dhe ndryshimin e procedurës së pezullimit të magistratit, përmes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkaqe që lidhen me verifikimin e pasurisë së tij. Pavarësisht se disa prej dispozitave janë rishikuar me ndryshimet fundit, të miratuara vetëm në Korrik të vitit 2019 për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2017, propozimi nëpërmjet reformulimit të tyre (si neni 152 i ligjit) deklarohet se justifikohet me nevojën që ka lindur për shkak se hetimet disiplinore mund të zgjasin deri në një vit", thuhet në njoftim.

"Presidenti i Republikës vlerësoi përputhshmërinë e ligjit nr. 15/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe konstaton se nenet 2, 4, 5, dhe 8 të tij, bien në kundërshtim me nenet 7, 42, 116, 140, 145, 147/a dhe 147/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Për këto arsye, këto dispozita duhen rishikuar, së bashku me dispozitat e tjera të ligjit që lidhen proceduralisht dhe materialisht me to", thuhet në njoftimin e presidencës.

## Freedom House: Kosova, pjesërisht e lirë

Në raportin e Freedom House, Kosova radhitet në mesin e vendeve pjesërisht të lira, dhe theksohet se zgjedhjet e kanë vënë në pushtet partinë nacionaliste Vetëvendosje, ku ajo ka një mundësi për ta ndryshuar kulturën e korrupsion në vend

PRISHTINË, 4 MARS - Raporti i grupit joqeveritar Freedom House me seli në Uashington, edhe sivjet e radhit Kosovën në mesin e vendeve pjesërisht të lira, së bashku me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Bosnjë e Hercegovinën. Në pjesën për Kosovën, raporti thekson se "zgjedhjet e kanë vënë në pushtet partinë nacionaliste Vetëvendosje, ku ajo ka një mundësi për ta ndryshuar kulturën e korrupsion në vend". Sa i përket Serbisë dhe Malit të Zi, raporti thotë se, gazetarët e pavarur, figura të opozitës dhe ata që perceptohen si armiq të qeverisë, janë përballur me ngacmime, kërcënime dhe nganjëherë edhe me dhunë. "Zhgënjimi i publikut me partitë qeverisëse kanë nxitur protesta

të mëdha në të dyja vendet, por ato nuk arritën të sjellin ndonjë ndryshim domethënës", thotë organizata. Një pjesë e raportit i kushtohet edhe Maqedonisë së Veriut ku thuhet se "vendi mbajti zgjedhje konkurruese presidenciale, duke ndihmuar në riparimin trashëgimisë jodemokratike të ish-kryeministrit Nikolla Gruevski". Lidhur me situatën e përgjithshme në Evropë, raporti thotë se "parimet e demokracisë liberale në Evropë, janë vënë nën presion serioz viteve të fundit". "Drejtesit dhe partitë populiste në Evropën Qendrore ruajtën ritmin e sulmeve ndaj institucioneve të pavarura gjatë këtij viti", thuhet në raport. Demokracia është nën sulm në të gjithë globin dhe efektet janë



të dukshme jo vetëm në shtetet autoritare si Kina, Rusia dhe Irani, por edhe në vendet me një përvojë më të gjatë në mbrojtjen të drejtave dhe lirive themelore. Kështu thuhet në raportin "Liria në botë 2020", të publikuar të mërkurën nga Freedom House - grup joqeveritar, me seli në Uashington.

Raporti gjithashtu ngrit alarmin për një minim të angazhimit të qeverive për pluralizëm - një tipar përcaktues i demokracisë liberale. "Pakicat etnike, fetare dhe grupet tjera kanë mbajtur barrën e abuzimeve shtetërore, si në vendet demokratike ashtu edhe në ato autoritare. Mungesa e

kontrollit, bën që shkelje të tilla të kërcënojnë lirinë e të gjitha shoqërive", thuhet në raport. Dy shembujt më të spikatur në raport janë Kina dhe India. Në Kinë, raporti thekson fushatën shumëvjeçare të regjimit për asgjësimin kulturor kundër pakicës ujgure dhe grupeve të tjera, kryesisht myslimane.

## Zgjedhjet parlamentare në Serbi mbahen më 26 prill

BEOGRAD, 4 MARS - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, shpalli 26 prillin e këtij viti datë të zgjedhjeve të përgjithshme, që shihen si shumë të rëndësishme për forcimin e pushtetit të ti Partisë së tij Përparimtare. "Të gjithë pjesëmarrësve u dëshiroj sukses dhe një



mjedis demokratik në ditën e votimeve", tha ai pasi nënshkroi dekretin për shpalljen e zgjedhjeve. Pjesa më e madhe e partive opozitare në Serbi kanë vendosur t'i bojkotojnë zgjedhjet, duke akuzuar presidentin serb për sundim autokratik, shkelje të lirisë së

medies, sulme ndaj veprimtarëve të opozitës, korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Presidenti serb dhe mbështetësit e tij që mbanin shumicën në parlamentin me 250 vende, i kanë mohuar vazhdimisht pohimet e tilla.

Pas vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), presidenti Hashim Thaçi ka mbajtur konferencë për media

# Thaçi: ShBA-ja është rikthyer fuqishëm në dialogun Kosovë - Serbi



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për media të mërkurën ka bërë me dije se takimi në Uashington, me presidentin e Serbisë, paraqet çast kthese në dialogun ndërmjet dy vendeve me lidhshmëri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Thaçi ka pohuar se Kosova duhet ta shfrytëzojë momentumin historik, pasi është një rol dhe interesim në rritje nga ShBA-ja dhe presidenti Donald Trump që të përmbillet ky proces me marrëveshje paqësore. Presidenti Thaçi ka kërkuar edhe unitet politik në Kosovë, ngjashëm me proceset e kaluara negociatore, në mënyrë që çështjet në dialogun me Serbinë t'i përmbillet me një unitet të brendshëm politik

Uashington. Kemi përkrahjen e plotë të presidentit Trump, vëmendjen e plotë të të ngarkuarit special me punë, ambasadorit Grenell. Kemi mundësinë për ta përmbyllur njëherë e përgjithmonë kapitullin e luftës, të konfliktit dhe armiqësisë”, ka thënë Thaçi. Thaçi ka kërkuar edhe unitet politik në Kosovë, ngjashëm me proceset e kaluara negociatore, në mënyrë që çështjet në dialogun me Serbinë t'i përmbillet me një unitet të brendshëm politik. “Ky është momentum i ri, mundësi e re të cilën ne të gjithë si institucione, si politikë, si shoqëri duhet ta shfrytëzojmë. Lëshimi i këtij momentumit nënkupton çmim. E para që duhet të bëjmë është të bëhemi bashkë të gjithë ne në Kosovë, i tërë spektri politik dhe institucional”, ka theksuar Thaçi.

ambasadorit Richard Grenell, të arrihet marrëveshja në të ardhmen e afërt. Prandaj, këtë momentum dhe këtë mundësi nga Uashingtoni duhet ta shfrytëzojmë edhe Kosova, edhe Serbia për arritjen e paqes si garanci për paqe në gjithë Ballkanin Perëndimor”, ka thënë Thaçi.

## PRESIDENTI: DO T'I TAKOJË TË GJITHË LIDERËT E PARTIVE POLITIKE, PËRFSHIRË EDHE KURTIN

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pas përfundimit të “Epopesë së UÇK-së” do t'i takojë të gjithë liderët e partive politike parlamentare, duke përfshirë edhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. “Unë do të takohem dhe do t'i ftoj për takim të gjithë liderët e partive politike, duke përfshirë edhe liderin e Vetëvendosjes dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, edhe atë të Nismës, edhe Behgjet Pacollin dhe gjithë të tjerët”, ka deklaruar Thaçi.

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 4 MARS** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka folur rreth vizitës së tij zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), veçanërisht për takimin që ka pasur në Shtëpinë e Bardhë me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është zhvilluar në praninë e Richard Grenellit dhe të këshilltarit për Siguri, Robert O'Brien.

Në pamundësi që t'u drejtohet deputetëve në një seancë të jashtëzakonshme, siç e kishte kërkuar, Thaçi u dashtë të thërrasë një konferencë për media. Presidenti Thaçi kishte kërkuar nga kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, që të mërkurën, më 4 mars, t'u drejtohet deputetëve në një seancë të jashtëzakonshme në lidhje me takimet e tij në Uashington. Por, kryetarja e Kuvendit, Osmani, e kishte njoftuar Thaçin se kërkesa e tij nuk e arsyeton seancën e jashtëzakonshme, kështu që ajo

do të thirret pas 9 marsit.

Thaçi ka thënë se pa e lënë anash ndihmën dhe angazhimin e Bashkimit Evropian në lehtësimin e deritashëm të dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit, megjithatë Brukseli nuk po tregon aftësi për të përmbyllur këtë proces me marrëveshje. Ai ka pohuar se BE-ja nuk po tregohet e aftë që t'i bindë as pesë vendet e saj anëtare që ta njohin shtetin e Kosovës dhe, njëherësh, nuk ka bërë as presionin më të vogël mbi Serbinë që të arrijë marrëveshje paqësore me Kosovën. “Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të BE-së ende nuk arrijnë që t'i bindin pesë vendet anëtare që ta njohin pavarësinë e Kosovës, ndërsa nuk shihet në horizont ndonjë shpresë që Bashkimi Evropian t'i bindë këto vende për ta njohur pavarësinë e Kosovës e lëre më ta bindin Serbinë që ta njohë Kosovën”, ka thënë Thaçi.

Në këtë aspekt, Thaçi tha se BE-ja nuk ka bërë as presionin më të vogël mbi Serbinë që të arrijë marrëveshje paqësore me Kosovën. Në këtë aspekt, Thaçi

ka pohuar se Kosova duhet ta shfrytëzojë momentumin historik, pasi që është një rol dhe interesim në rritje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti Donald Trump që të përmbillet ky proces me marrëveshje paqësore. “Me ftesë të Richard Grenellit dhe në prani të Këshilltarit për Siguri, Robert O'Brien, më 2 mars jam takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ky takim është i rëndësishëm për disa arsye, së pari shënon rikthimin e fuqishëm të ShBA-së në procesin e kërkimit apo mundësisë së arritjes së marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi”, ka thënë Thaçi, duke shtuar se në Kosovë, pa dallim, institucionet, partitë, shoqëria civile, mediat të gjithë qytetarët kanë kërkuar praninë amerikane në këtë proces dhe Uashingtoni të marrë rol udhëheqës. “Takimi në Uashington është i rëndësishëm sepse e lehtëson apo mund ta bëjë edhe me të afërt arritjen e marrëveshjes. Takimi i bënë me reale gjasat që diçka e tillë e munguar që dy dekada të mund të arrihet në

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se koalicion qeverisës LV - LDK ende nuk ka prezantuar program qeveritar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Shala ka theksuar se ky koalicion qeverisës nuk ka koordinim as për taksën 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. Ai ka thënë se për shkak të lojës me taksën kemi edhe përkeqësim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë. Duke folur për shkarkimet e disa bordeve nga qeveria Kurti, ai ka thënë se këto shkarkime janë bërë pa analizë të mirëfilltë. Shala ka thënë se është bërë shkelje flagrante me shkarkimin e bordit të “Trepçës”



FLET PËR “EPOKËN E RE”, FERAT SHALA

# KOSOVA PO PËRKEQËSON RAPORTET ME NDËRKOMBËTARËT PËR SHKAK TË TAKSËS

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 MARS - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i cili është dhe anëtar i Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, Ferat Shala, ka thënë PDK-ja si parti opozitare do të ketë një rol konstruktiv në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në shërbim të shtetit dhe në konsolidim të ekonomisë së vendit dhe projekteve zhvillimore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se ky koalicion qeverisës LV-LDK ende nuk ka

prezantuar program qeveritar. Ai ka thënë “së fundi u kuptua se nuk kanë plan as për taksën, nuk kanë plan as për projektet zhvillimore dhe për asnjë punë”, ka thënë Shala, duke shtuar se në këtë çështje Kosova ka edhe përkeqësim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë. “Po ashtu, kemi edhe përkeqësim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë për shkak të lojës me taksën dhe që në parim janë duke e stagnuar zhvillimin e vendit, duke bërë kështu që ende mos të kemi plan buxhetor për këtë vit të miratuar”, ka theksuar Shala. Duke folur për shkarkimet e disa bordeve nga qeveria Kurti,

ai thotë se këto shkarkime po bëhen pa analizë të mirëfilltë. Shala ka thënë se është bërë shkelje flagrante me shkarkimin e bordit të “Trepçës”.

**“Epoka e re”:** Z. Shala, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen LV-LDK?

**Shala:** Në parim mungesa e planit të qeverisë reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë në planin e punës të komisioneve parlamentare, veçanërisht të atij për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike. Ne nuk mund ta hartojmë një plan të mirëfilltë pune si parlamentar pa pasur një plan qeveritar, në mënyrë që ne ta

fillojmë trajtimin e problemeve reale që sot ballafaqohet ekonomia dhe shoqëria në vend. Mungesa e planit të qeverisë është me pasojë të drejtpërdrejta në punën e parlamentarëve të Kosovës.

**“Epoka e re”:** Mbase kishin një plan qeverisës të prezantuar nga z. Kurti në ditën që u votua qeveria e tij. Cila është përshtypja juaj për këtë plan qeverisës?

**Shala:** Në parim nuk ishte plan, ishin disa pika teorike të atij plani pa asnjë elaborim, afatizim apo plan kohore konkret, duke anashkaluar kështu dhe eksplorimin zhvillimor të tij. Pas paraqitjes

së atyre pikave në Kuvendin e Kosovës nga z. Kurti që nga ajo ditë më nuk kemi asnjë elaborim apo dokument zyrtar në duart e parlamentarëve. Pra, vetëm janë paraqitur dhe lexuar disa pika të planit.

**“Epoka e re”:** Ju keni qenë drejtor në “Trepçë”, ndërkohë para disa ditësh Qeveria e Kosovës mori vendim që ta shkarkojë bordin e “Trepçës”, marrë parasysh rrethanat në të cilat ndodhet ky institucion. Si e vlerësoni shkarkimin e këtij bordi?

**Shala:** Gjithmonë kur ngutesh edhe mund të gabosh. Ai bord ka respektuar ligjet në fuqi dhe veprimet e qeverisë, mirëpo për

politike nuk mund të ketë rimëkëmbje të "Trepçës". Po ashtu, as me ndërhyrje të grupeve të interesit dhe të pushtetit lokal të koordinuar mirë me pushtetin qendror. Në grupe dhe në interes për politika ditore nuk ka rimëkëmbje të "Trepçës".

**"Epoka e re": Tani u hap gara elektorale për zgjedhjet në Podujevë. Cilat janë pritjet e juaja për këtë komunë?**

**Shala:** Pritjet tona janë të natyrshme. Si PDK kemi një kandidat të shkëlqyer, i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve. Presim të gjithë qytetarët e rajonit të Llapit ta bëjnë ndryshimin e madh, i cili mund të ndodhë më 15 mars.

**"Epoka e re": Cili do të jetë roli i PDK-së si parti opozitare?**

**Shala:** Partia Demokratike e Kosovës do ta ketë një rol konstruktiv në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në shërbim të shtetit dhe në konsolidim të ekonomisë së vendit dhe projekteve zhvillimore. Pra, çdoherë duke pasur për bazë të ardhmen e vendit. Gjithsesi në luftë të pakompromis me anë të politikave legale, kundër abuzimeve që ka filluar t'i bëjë qeverisja aktuale me shkarkimet e bordeve pa analizë të mirëfilltë ekonomike. Po bëhen dy muaj që nuk kemi program qeveritar. Po ashtu, kemi edhe përkeqësim të raporteve me partnerët ndërkombëtarë për shkak të lojës me taksën dhe që në parim janë duke e stagnuar zhvillimin e vendit, duke bërë kështu që ende mos të kemi plan buxhetor për këtë vit të miratuar. Ne kemi një plan buxhetor vetëm për muajin mars dhe ende nuk e kemi buxhetin e plotë. Gjithashtu, nuk e kemi planin e qeverisë dhe nuk kemi asnjë projekt zhvillimor të prezantuar në tavolinën e punës. Pra, jemi duke u marrë me të kaluarën dhe duke ricikluar demagogji elektorale.

**"Epoka e re": Kemi një lloj dykuptueshmëri të koalicionit sa i përket tarifës 100 për qind ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës marrë parasysh edhe seancën e kaluar. Cili është këndvështrimi juaj për këtë?**

**Shala:** Koalicioni qeverisës nuk do të ketë harmonizim në këtë pikë. Do të kenë dhunshëm një pajtueshmëri për interesa të caktuara apo për shkak të presionit të caktuar. Fatkeqësia e vendit, e ekonomisë dhe zhvillimit, është saktësisht në këtë pikë. Së fundi u kuptua se nuk kanë plan as për projektet zhvillimore dhe për asnjë punë. Edhe pse kishin deklaruar se 'ne i kemi harmonizuar planet qeveritare zhvillimore', në seancën parlamentare e së hënës u pa që nuk kanë asnjë plan zhvillimor dhe programor për vitin që jemi.

ta shkarkuar bordin pa analizë të mirëfilltë ekonomike dhe pa analizë hulumtuese zyrtare të organeve përgjegjëse kompetente është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në organet e pavarura, pra të ndërmarrjeve dhe agjencive, pasi që nuk ka qëndrim zyrtar të asnjë mekanizimi shtetëror legal që ata kanë bërë ndonjë shkelje. Prandaj, shkelja e madhe është bërë nga qeveria me shkarkimet e tyre mbi bazën e thashethemeve dhe grupeve të interesit që parimisht po sillen. Për këtë fakti më i mirë është kur praktikisht zëvendëskryeministri i Kosovës, Haki Abazi, aprovon vazhdimin e procedurave të konkursit edhe pse parimisht nuk do të duhej fare të përfshihej në të. Janë organet e drejtësisë dhe organet legale të shtetit që duhet të funksionojnë në çdo konkurs dhe për çdo vend pune ku supozohet se ka shkelje, por jo politika, jo ministritë dhe zëvendëskryeministrat për të shkuar atje dhe për t'u marrë me çështje që janë të definuara ligjërisht. Prandaj, mund të themi se është bërë shkelje flagrante me shkarkimin e bordit të "Trepçës".

**"Epoka e re": Sipas jush, si mund të rimëkëmbet ky institucion?**

**Shala:** Në parim, me politika ditore nuk mund të rimëkëmbet "Trepça". Mund t'ju them se me këto ndërhyrje

# SOT SHËNOHET 22-VJETORI I 'EPOPESË SË UÇK-së'

Sot (e enjte) në të gjitha shkollat e vendit ora e parë mësimore në të gjitha shkollat do t'i kushtohet "Epopesë së UÇK-së", ndërkaq në orën 9:00 në Kuvendin e Kosovës do të mbahet seancë solemne, ku do të flasin kryeparlamentarja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. Në orën 12:00 në Kazermën "Adem Jashari" do të parakalojë Ushtria e Kosovës. Aty do të mbajnë fjalime presidenti Hashim Thaçi, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe përfaqësues nga familja Jashari

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 4 MARS** - Sot (e enjte) shënohet 22-vjetori i "Epopesë së UÇK-së". Me rastin e këtij përvjetori, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë aktivitete të shumta në nivel qendror dhe atë lokal. Sot (e enjte) ora e parë mësimore në të gjitha shkollat do t'i kushtohet "Epopesë së UÇK-së", ndërkaq në orën 9:00 në Kuvendin e Kosovës do të mbahet seancë solemne, ku do të flasin kryeparlamentarja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti. Po ashtu, të enjten kuvendet komunale do të mbajnë seanca solemne. Në orën 12:00 në Kazermën "Adem Jashari" do të parakalojë Ushtria e Kosovës. Aty do të mbajnë fjalime presidenti Hashim Thaçi, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe përfaqësues nga familja Jashari.

Sipas planit të qeverisë, më 6 mars (e premte) do të ketë vizita të liderëve shtetërorë në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Po ashtu, më 6 mars do të bëhen homazhe në të gjithë komplekset përkujtimore të dëshmorëve të UÇK-së. Gjithashtu, po të premten në orën 17:00, në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve do të mbahet akademi përkujtimore kushtuar komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve dhe të rënëve për liri. Të pranishmëve në këtë akademi do t'u drejtohen me fjalime Hashim Thaçi, Vjosa Osmani, Albin Kurti, historiani prof. Agim Vinca, kryetari i Shoqatave të Dala nga Lufta, Hysni Gucati dhe përfaqësues nga familja Jashari. Aktivitetet për shënimin e 22-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së" do të vazhdojnë edhe më 7 mars, ku kryeministri Albin Kurti dhe kryeparlamentarja

**SOT NË  
BIBLIOTEKËN  
KOMBËTARE  
"PJETËR  
BOGDANI"  
MBAHET  
"ORA E  
LIRISË"**

Sot (e enjte) në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" mbahet akademia letrare-artistike "Ora e Lirisë" në shenjë të luftës çlirimtare të UÇK-së dhe dëshmorëve të rënë për liri. Punimet e tyre do t'i lexojnë rreth 40 poetë nga vise të ndryshme të trojeve shqiptare, kurse poezia më e mirë e vlerësuar nga juria letrare do të nderohet me çmimin letrar "Adem Demaçi". Marrin pjesë anëtarë të LShK-së dhe poetë që kanë marrë pjesë në konkursin letrar të LShK-së.

Vjosa Osmani në orën 12:00 do të bëjnë homazhe pranë shtëpisë së familjes Jashari në Prekaz. Po ashtu, më 7 mars në orën 18:00 në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz do të ndizen flakadanët dhe më pas vijon programi kulturor-artistik, i cili do të mbahet në sheshin "Adem Jashari" në Skenderaj.



## Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin do t'i ndërtojë urat e paqes mes komuniteteve

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë të mërkurën në panelin për hulumtimin e perceptimeve të opinionit publik për nismën për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin. I pari i vendit theksoi se dëshmia më e mirë që nisim për formimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin ka qenë e duhur është hulumtimi që u prezantua sot, i cili vërteton se njerëzit kanë nevojë të dinë se çfarë ka ndodhur në luftë. "Qytetarët besojnë se e vërteta do t'i ndërtojë urat e vërteta të pajtimit, të paqes dhe të shikimit kah e ardhmja në paqe", deklaroi presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi shtoi se Kosova është e angazhuar për arritjen e një marrëveshjeje paqësore, të përhershme, në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila duhet ta sjellë

njohtën reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara si dhe ta përshpejtojë rrugëtimin për në NATO dhe BE.

Presidenti Thaçi deklaroi se takimi në Shtëpinë e Bardhë është një moment i kthesës pozitive për procesin e dialogut. "Takimi dy ditë më parë në Shtëpinë e Bardhë, në mes të presidentëve të të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, besoj se do të jetë takimi dhe momenti i kthesës pozitive, që nën udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe lidershit të presidentit Trump, dinamikës dhe mençurisë së ambasadorit Grenell, të arrihet marrëveshja në të ardhmen e afërt", ka thënë kreu i shtetit. Ky momentum, sipas presidentit Thaçi, duhet të shfrytëzohet nga të dyja palët.



## Dumoshi pret në takim Minxhozin, diskutojnë për bashkëpunimin në fushën e kulturës

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur të mërkurën në një takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Ministrja Dumoshi ka vlerësuar se Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë një bashkëpunim konkret në fushën e kulturës siç është kalendari i përbashkët kulturor dhe ky projekt i përbashkët duhet të pasurohet edhe më shumë me aktivitetet të tjera, porse duhet të realizojnë edhe projekte të tjera të përbashkëta mes dy vendeve tona edhe në fushat e tjera. "Projekti në fjalë ka shërbyer si një shembull bashkëpunimi mes



dy vendeve edhe për institucionet e tjera të nivelit qendror dhe atij lokal", ka vlerësuar ministrja Dumoshi. Gjithashtu, ministrja Dumoshi ka theksuar se përmes shkëmbimit

të përvojave të mira dhe ekspertëve të fushave të veçanta, kultura do të avancohet në një nivel tjetër andej e këndej kufirit. Në kuadër të zhvillimit të politikave të mirëfillta, duhet të

rritet bashkëpunimi i mëtejshëm në mes të Kosovës e Shqipërisë, varësisht prej ideve e projekteve që ekspertët e fushave përkatëse propozojnë e parashohin. Ministrja u shpreh se është e gatshme të ofrojë çdo mbështetje në lidhje me zhvillimin dhe koordinimin sa më të mirë për avancimin e këtij bashkëpunimi përmes organizimeve të përbashkëta, duke realizuar projekte substanciale dhe që do të ndikojnë në prezantimin sa më të mirë të kulturës shqiptare në përgjithësi edhe në arenën ndërkombëtare. Ndërkaq ambasadori Minxhozi ka uruar ministrën për marrjen e detyrës dhe ka theksuar se

bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë duhet të vazhdojë duke u shtuar edhe me tej përmes hapave dhe projekteve konkrete dhe të përcaktuara saktë.

Vlora Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po ashtu ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Republikës së Francës në Kosovë, Marie-Christine Butel, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin dhe synimet e deritanishme të arritura në fushat të cilat janë në përgjegjësinë dhe mandatin e MKRS-së si dhe për vazhdimin e mëtejshëm të thellimit të relacioneve mes dy vendeve në këto fusha.

## Shtohen veprimet për parandalimin e narkotikëve në Burgun e Dubravës



PEJË, 4 MARS (ER) - Koordinatorin për veprat penale për narkotikë në Prokurorinë Themelore të Pejës, prokurori i shtetit, Ardian Hajdaraj, ka mbajtur takim me Policinë e Kosovës, përkatësisht nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë, Njësitin e Hetimit të

Trafikimit të Narkotikëve dhe udhëheqësit e Burgut të Dubravës, lidhur me veprat penale të narkotikëve që ndodhin brenda hapësirave të kësaj qendre korrektuese. Gjatë këtij takimi është diskutuar për shtimin e veprimeve për

parandalimin e trafikimit të narkotikëve brenda Qendrës Korrektuese të Burgut të Dubravës, ku gjatë diskutimeve janë marrë disa rekomandime të cilat do të ndikojnë në parandalimin e kësaj dukurie. Disa nga rekomandimet e nxjerra

gjatë këtij takimi kanë të bëjnë me shtimin e masave siguroese brenda Burgut të Dubravës. Gjithashtu, të pranishmit u pajtuan që këto rekomandime të realizohen në afatin optimal dhe njëkohësisht takimet e tilla të mbahen çdo tre muaj.

## Gjini takohet me rektorin e Universitetit "Fehmi Agani", flasin për ndërtimin e kompleksit universitar

GJAKOVË, 4 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka vizituar Universitetin Publik "Fehmi Agani" në Gjakovë, me ç'rast është pritur nga rektori i këtij universiteti


Artan Nimani. Kryetari Gjini e ka vlerësuar lart punën që po bëhet në këtë institucion të arsimit të lartë, ndërsa ka premtuar se në bazë të të gjitha kompetencave dhe mundësive që ka si kryetar i

komunës, do të jetë në mbështetje të vazhdueshme të Universitetit të Gjakovës. Një ndër temat më të rëndësishme të trajtuara gjatë këtij takimi ka qenë edhe projekti për ndërtimin e

kompleksit universitar, me ç'rast nga të dyja palët u tha se ndërtimi i këtij kompleksi do të ndikojë që Gjakova të kthehet në një qendër të rëndësishme universitare dhe shkencore.



# AKADEMIA MBARËKOMBËTARE E SHKENCAVE DHE E ARTEVE QË DUHET TA KEMI



Rexhep QOSJA

## Përbërja e saj

Para më tepër se një viti ishte bërë publike nisma për krijimin e një Akademie të përbashkët të shkencave dhe të arteve të Shqipërisë e të Kosovës.

Kjo Akademi, ishte thënë, do të përbëhej prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe prej Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës.

Nisma në fjalë, e bërë publike prej Qeverisë së Shqipërisë, në të vërtetë prej Kryeministrit Edi Rama, ishte përkrahur prej një numri të vogël krijuesish dhe ishte kundërshtuar prej një numri po ashtu të vogël krijuesish.

Mjerisht, pas pak ditësh, për shkak të konflikteve të ndërsjella politike të disa forcave partiake kjo nismë historikisht e rëndësishme do të lihet në harresë!

Meqenëse angazhimet për çështje të mëdha është e nevojshme të përsëriten në qoftë se duam që të sendërtohen, le të thuhet rishtazi disa fjalë për të.

Në qoftë se krijimi i kësaj Akademie të përbashkët shtetërore megjithatë do të kundërshtohet vendosmërisht prej dy akademive të tanishme - prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe sidomos prej

Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës, Akademia e dy shteteve shqiptare do të mund të krijohej duke qenë edhe më tej dy akademitë në fjalë: duke qenë gjithnjë deri në ditën e shkrirjes së pashmangshme në të.

Akademia e përbashkët e Shqipërisë dhe e Kosovës do të quhej Akademia Mbarëkombëtare e Shkencave dhe e Arteve.

Ajo do të krijohej prej akademikëve të akademive të tanishme të Shqipërisë dhe të Kosovës, që do të kërkonin të bëheshin anëtarë të saj dhe prej krijuesve të tjerë të shquar të shkencave dhe të arteve nga Shqipëria, nga Kosova, nga trojet e tjera me shumicë shqiptare në Ballkan dhe nga diaspora.

Selia e kësaj Akademie do të ishte disa vite në Shqipërinë shtetërore, si shteti i parë, shteti amë i shqiptarëve dhe po aq vite në Kosovë, në shtetin e dytë shqiptar. Krijimi i kësaj Akademie Mbarëkombëtare të Shkencave dhe të Arteve është shumë i nevojshëm për arsye të zhvillimit të mëtejshëm të gjithanshëm e më të dukshëm, më të çmuar se tani, të shkencave e të arteve tona, kurse sot edhe për arsye politike e kombëtare.

## Rëndësia e veprimtarisë së saj shkencore e artistike mbarëkombëtare

Akademia në fjalë do të luante rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për organizimin, për mbarëvajtjen e bashkërendimin, për politikën e planifikimin, për strategjinë e zhvillimit të shkencave dhe arteve shqiptare në rrafsh mbarëkombëtar, për merendimin e punëve kërkimore shkencore dhe për publikimin e rezultateve të atyre kërkimeve shkencore.

Ajo do ta bënte të mundshëm shfrytëzimin e burimeve dhe të mundësive shkencore, profesionale dhe materiale vendore e ndërkombëtare për zhvillimin e të gjitha shkencave me interes për shqiptarët dhe shtetet shqiptare.

Ajo, me planet dhe me programet kërkimore shkencore dhe me krijimtarinë e saj mendore në përgjithësi, do ta bënte të mundshme dëshminë me të dhëna të burimeve vendore e ndërkombëtare për njësinë e vazhdimësisë historike shqiptare, që në një varg botimesh tona të tanishme del e ndërprerë jo vetëm në vitin 1912-1913.

Ajo, me krijimtarinë shkencore, letrare e artistike në përgjithësi të anëtarëve e të bashkëpunëtorëve të saj, do ta bënte të mundshme dëshminë e njësisë së përbashkët letrare, artistike, kulturore në përgjithësi të popullit shqiptar, të ndërprerë, thuhet, sidomos, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ajo, me politikën e saj kërkimore shkencore, me përkushtimet e saj të deklaruara ndaj parimësisë dhe objektivitetit shkencor do të bënte të mënjanoheshin, në njërin anë zhvlerësimet e tanishme kundërshkencore propagandistike të ndonjë etape e të disa figurave historike, kurse, në anën tjetër glorifikimet folklorizuese të ndonjë etape e të ndonjë figure të historisë sonë politike e kulturore.

Ajo do të bënte të mundshme që në planet dhe programet e saj t'u kushtohet kujdes edhe temave e çështjeve me karakter të përgjithshëm teorik, metodologjik, gjithënjëzësor, tani të padukshme në veprimtarinë tonë shkencore.

Ajo do të bënte të mundshme realizimin e projekteve madhore shkencore në të gjitha fushat shkencore e në ato artistike, nisur nga historia e përbashkët shqiptare, historia e letërsisë

shqipe pa cenimet e saj regjionale, fetare e ideologjike, e deri te fjalorët, leksikonët dhe enciklopeditë shkencore me rëndësi mbarëkombëtare, por edhe realizimin e projekteve të përbashkëta nga fushat e tjera shkencore: gjeografi, gjeologji, gjeodezi, sizmologji, ekonomi, drejtësi, mjekësi, bujqësi, tekniko-informatikë e shumë të tjera, me rëndësi të dorës së parë për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shqiptarëve e të shteteve shqiptare.

Ajo do të bënte të mundshme që të mënjanoheshin sundimi partiak dhe padrejtësitë që u janë bërë jo pak krijuesve të shkencave e të arteve gjatë zgjedhjeve domethënë gjatë pranimit në dy akademitë e tanishme, sidomos në Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës me pasojat të mëdha për zhvillimin e shkencave, të letërsisë dhe të arteve tona në përgjithësi.

E ato padrejtësi kanë sjellë edhe krijimin e Akademisë Shqiptare të Arteve e të Shkencave me qendër në Tiranë, që në dhjetor 2011, në të cilën janë zgjedhur krijues të shquar shqiptarë shkencorë e artistikë: Luljeta Bozo, Emil Lafa, Xhevat Lloshi, Shefikje Islamaj, Pëllumb Xhufi, Agim Vinca, Ksenofon Krisafi, Moikom Zeqo, Pandeli Çina, Romeo Gurakuqi, Fatos Tarifa, Skënder Minxhozi. E të tjerë. Ajo do të bënte të mundshme që të parandaloheshin shpenzimet e panevojshme për kërkime e studime të të njëjtave tema e çështje, që ndodhin tashmë në të njëjtën kohë në Shqipëri, në Kosovë e kudo ka institucione arsimore-shkencore në gjithë hapësirën shqiptare.

## Roli i saj për parandalimin e ideologjisë dhe politikës separatiste në jetën kombëtare

Ajo do të bënte të mundshme që të komprometoheshin ideologjia dhe politika separatiste, të përmbajtura në lokalizmat dhe në krahinorizmat tona mjerisht ende të dukshme në Shqipëri e në Kosovë.

Ajo, me vepra e me veprimtari shkencore e publicistike, letrare e artistike, do të bënte të mundshme që të tregoheshin pasojat e mëdha politike e kombëtare, të sotme e të ardhme, të përpjekjeve për krijimin e kombit kosovar, si një prej

përpjekjeve të kahershme të klasës politike dhe intelektuale serbe, kur e kur edhe malazeze e maqedonase, për veçimin e shqiptarëve të Kosovës prej albancave të Shqipërisë.

Ajo, me veprimtarinë e saj kërkimore shkencore dhe me paraqitjet e saj publike, do të bënte të mundshme që të mposhtej ideja kundërkombëtare e atyre udhëheqjeve akademike dhe e atyre akademikëve që e përjashtojnë, duke e quajtur të pamundshëm e të palejueshëm, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, domethënë bashkimin e Kombit të ndarë shqiptar!


Ajo, Akademia Mbarëkombëtare e Shkencave dhe e Arteve me ekzistimin e saj, me veprimtarinë e saj, me veprat e saj shkencore të fushave të ndryshme, me veprat e saj letrare, me veprat e saj artistike, me autoritetin e saj kulturor e qytetëruar do të bëhej dëshmi e të drejtës së Kosovës e të Shqipërisë për t'u bashkuar në një shtet.

## Misioni i dy Qeverive për themelimin e saj

Ajo, Akademia Mbarëkombëtare e Shkencave dhe e Arteve me përbërjen e saj, me krijimtarinë e saj shkencore, me krijimtarinë e saj gjuhësore, me krijimtarinë e saj historike, me krijimtarinë e saj letrare, me krijimtarinë e saj artistike si dhe me autoritetin e saj moral do të bëhej institucion me rol të veçantë, të madh, në jetën tonë shoqërore, kulturore, politike, arsimore, ekonomike. E të tjera. Si e tillë ajo do të ushtronte ndikim të përtashëm dhe historik për parandalimin e përshtirjes së sotme të shpërfytyrimeve dhe kundërvlerave që njëmendësinë tonë, aq shumë të përdorur e shpërdorur prej politikës e medie, e kanë privuar prej sistemit të vlerave! Qeverisë së sotme të Shqipërisë, Qeverisë së sotme të Kosovës iu takon detyrë historike që, për shkak të arsyeve të sipërthëna, të vendosin për krijimin e kësaj Akademie Mbarëkombëtare të Shkencave e të Arteve.

Le të thuhet në fund se një prej obligimeve të para të mëdha të misionit historik të këtyre dy qeverive në këtë kohë mundësisht dhe sfidash të ndryshme të Kombit shqiptar është pikërisht krijimi i kësaj Akademie.

# TAKSA PLUS RECIPROCITETI



Nga Jakup KRASNIQI

Kosova dhe politika e saj që nga Konferenca e Rambujesë, bisedimet e Vjenës dhe deri tek Aktvendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ka bërë shumë kompromise. Kompromise këto të njohura edhe nga Komuniteti Ndërkombëtar, Grupi i Kontaktit, veçmas nga ShBA-ja dhe BE-ja. Prandaj GjND-ja tha se Pavarësia e Kosovës nuk ka rënë ndesh me Ligjin Ndërkombëtar. Pas kësaj, politika e shtetit tonë nuk ishte në shërbim të shtetit tonë, por të individit. Këto politika

fëmijërore kanë krijuar këtë gjendje kaotike brenda kombit. Në vitin 2012 politika e Kosovës e pat bërë kompromisin më kompromentues, kur bisedimet teknike, të kërkuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me një Rezolutë joobliguese pat kërkuar që në mes të Kosovës e Serbisë, me mbikëqyrjen e Brukselit të fillonin bisedimet teknike, të cilat patën filluar në vitin 2011, e pas një viti, pa asnjë debat përmbajtësor u shndërruan në bisedime politike. Kështu për Kosovën e proceset politike u "hap kutia e Pandorës", nga e cila dolën të gjitha të këqijat dhe në vend të premtiveve e deklarimeve premtuese të qeveritarëve për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Ne jo vetëm që nuk pamë normalizim, por pamë momente që krijuan situata konflikti e pasigurie në mes të Kosovës e Serbisë. E këto të

këqija janë bërë një gangrenë rrënuese për politikën tonë të çakorduar, e cila po sillet e pëshitillet si "çurat në mjegull"?! Kjo u pa edhe në seancën e fundit të Kuvendit që u mbajt më 2 mars 2020, ku u bisedua për "Mosheqjen e taksës 100 për qind" të vendosur nga qeveria e kaluar për mallrat që vijnë në Kosovë nga Serbia e Bosnja e Hercegovina. E, në fakt, shumica ishte për heqjen e taksës. Ndërsa politikat e koalicionit qeverisës ishin krejtësisht të çakorduara, siç thuhet dikush thumbit e dikush patkoit. Të gjithë e dimë, veç atyre që po e fusin kokën në rërë si struci, se taksa 100 për qind që u vendos nga Qeveria e kaluar e Kosovës nuk ishte masë ekonomike, por ishte masë puro politike. Kush nuk e ka kuptuar këtë, qoftë nga tabori ekonomik apo politik, nuk ka kuptuar asgjë ose dëshiron të

vihet në shërbim të politikave të huaja. Ndërsa ne e dimë se në Kosovë kurrë nuk e kanë pushuar aktivitetin argatët e huaj, sado që ata mund të maskohen sot! Madje sot në Republikën tonë nuk po kanë ndonjë nevojë për maskim. Kjo më se miri shihet nga trajtimi që i bëhet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka bërë që sot në Kosovë të bëhet çështje: Të hiqet apo të mos hiqet taksa 100 për qind?! Nëse, deri me dje, ka pasur ndonjë arsyeje që të diskutohet çështja e taksës, politika serbe me angazhimet e saj jo vetëm për heqjen e njohjeve, po tregon se mbajtja e taksës 100 për qind është bërë e pamjaftueshme. Në një situatë të tillë, taksës duhet t'i shtohet si përforcim edhe reciprocitetin politik, ekonomik e diplomatik. Për këto veprime, Qeveria e Kosovës duhet t'i njoftojë: OKB-në, BE-në dhe sidomos ShBA-

në. Kosova dhe miqtë e saj duhet ta kenë të qartë se me politika të qullëta nuk mund të normalizohen marrëdhëniet me Serbinë e pinjollëve të Millosheviqit. Bashkë me këtë veprim, jo vetëm politika e Kosovës, por edhe ajo e Shqipërisë dhe e shqiptarëve në përgjithësi, duhet t'i ndryshojnë të gjitha politikat e deritashme të veprimit, përfshirë edhe politikat e komunikimit në mes të krerëve të institucioneve shtetërore. Me politikat e deritashme të konfrontimeve të brendshme nuk duhet të dalin jashtë kapinxhikut të oborrit. Shqiptarët duhet të bisedojnë më seriozisht se kurrë më parë për sigurinë e kombit në të ardhmen. Për t'u siguruar kombi ynë, është i domosdoshëm bashkimi politik i tij! Koha është që të nisim bisedime serioze për këtë çështje.

## PDK-ja kundërshton idenë që e diela të jetë ditë pushimi në Prishtinë

PRISHTINË, 4 MARS (ER) - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë, Uran Ismaili, është shprehur kundër propozimit që e diela të jetë ditë pushimi në kryeqytet. Ai ka thënë se Prishtina me dyer të mbyllura të dielën është mundësi që komunat afër saj, siç është Graçanica, të fillojnë të marrin fokus për investime. "As gjatë qeverisjes të LDK-së e LV-së e as sot nuk kemi investime që e bëjnë Prishtinën qytet me parqe, me hapësira për të rinj, miqësor për të moshuar e të shëndetshëm për të gjithë. Prishtina është qytet atraktiv për shkak të qytetarëve të Prishtinës, por jo pse qeverisjet e kanë ndihmuar apo mbështetur atë. Dëshira për ta kufizuar energjinë e ndërmarrësisë të qytetarëve në



jetën e Prishtinës ngufat edhe të vetmen energji që e ka mbajtur gjallë këtë qytet. Kjo tentativë e

propozuar që Prishtina të paralizohet ditën e diel është tentativë për t'u shfajësuar para

qytetarëve të Prishtinës për investimet e mirëfillta që na mungojnë çdo ditë në kryeqytet.

Prishtina me dyer të mbyllura të dielën është mundësi që komunat afër Prishtinës si Graçanica të fillojnë të marrin fokus për investime. Për më tepër, Shkupi e Tirana do të presin me padurim ardhjen e kosovarëve në këto qytete", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook". Ismaili ka thënë se vendosja e masave radikale si kjo që po diskutohet sot nënkupton më pak vende pune për Prishtinën, më pak investime dhe më pak zhvillim për kryeqytetin. "Kryeqytetit tonë edhe ashtu të varfër për nga investimet publike, të degraduar nga të gjitha qeverisjet, nuk është mirë t'i vihen masa radikale që ia dobësojnë konkurrueshmërinë kundrejt kryeqyteteve përreth", ka thënë Ismaili.

## Vihet gurthemeli i ndërtimit të ujësjellësit për zonën lindore të Komunës së Istogut

ISTOG, 4 MARS (ER) - Të mërkurën është vënë gurthemeli për fillimin e punimeve të projektit të shumëpritur dhe jetik "Ndërtimi i ujësjellësit për zonën lindore të Komunës së Istogut" (Pjesa e Mbivadës). Ndërtimi i këtij ujësjellësi do t'i furnizojë me ujë të pijshëm 12 fshatra të kësaj ane. Pjesë e kësaj ngjarje ishte kryetari i Komunës së Istogut, Haki Rugova, përfaqësues të nivelit qendror si dhe përfaqësuesit e kompanisë austriake OSTAP dhe

Tirohler Rohre. Rugova ka thënë se ky projekt ka filluar në vitin 2015 dhe është bashkëpunim i Komunës së Istogut me Republikën e Kosovës dhe të Austrisë. "E ndiej veten shumë krenar që ky projekt po fillon sot. Nga ky projekt Komuna e Istogut do të sigurojë 24 orë ujë të pijshëm për qytetarët e saj me çdo cep. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me qeverinë austriake për projektet e tjera me rëndësi të cilat do t'i marrim në formë kreditimi, që jemi të

orientuar më shumë te kanalizimet që të zgjidhet çështja e kanalizimeve", ka thënë Rugova. Qytetarët e zonës së Mbivadës në Istog shumë shpejt pritet të kenë furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm si rezultati i projektit "Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit për zonën lindore të Komunës së Istogut, projekt ky i cili po realizohet si bashkëpunim në mes të Komunës së Istogut, Qeverisë së Kosovës si dhe Qeverisë së Austrisë.





# Buxheti për vitin 2020 ende në fazën e harmonizimit

PRISHTINË, 4 MARS - Qeveria e Kosovës ende nuk e ka aprovuar buxhetin e këtij viti. Zyrtarë të Ministrisë së Financave dhe Transfereve thonë se janë duke punuar për harmonizimin e buxhetit dhe këtë do ta bëjnë brenda afatit ligjor në mënyrë që vendi mos të hyjë në krizë.

Kosova pati hyrë në vitin 2020 pa buxhet të miratuar për shkak se në kohën kur ishte dashur të miratohet, Kosova nuk e kishte zgjedhur qeverinë e re e cila kishte dalë nga zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit.

Muharrem Shahini, drejtor në zyrën për komunikim me publikun në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se janë në përfundim e sipër të harmonizimit të buxhetit dhe se brenda këtyre muajve do të jetë i gatshëm. "Sa i përket buxhetit për vitin 2020, ministri i Financave dhe Transfereve,

Besnik Bislimi, bashkë me stafin e ministrisë është duke punuar intensivisht për harmonizimin e buxhetit në përputhje me programin e qeverisë së kryeministrit Albin Kurti, në mënyrë që sa më shpejt të dërgohet në qeveri për miratim dhe pastaj për aprovim në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Shahini.

Me autorizimet ligjore, Ministria e Financave e qeverisë së kaluar pati bërë zgjatjen e ndarjeve buxhetore dhe alokimin e mjeteve për organizatat buxhetore për 2 muajt e parë të vitit 2020, ku i jepet mundësia për të vepruar me buxhet një e dymbëdhjeta e vitit paraprak.

Kurse për muajin mars, pas kërkesës së ministrit të Financave dhe Transfereve Besnik Bislimi, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar që ndarja buxhetore për vitin 2020 të zgjatet edhe për muajin

mars. Kjo është koha përfundimtare e lejuar për shpenzim buxheti dhe nuk ka asnjë instrument tjetër ligjor që ndarjet buxhetore të shtyhen më shumë se tre muaj, pra jo më vonë se data 31 mars 2020.

Buxheti i Kosovës në vitin 2019 ishte rreth 2.3 miliardë euro. Për vitin 2020, sipas Muharrem Shahinit, do të jetë më i lartë, por që ende nuk dihet vlera e saktë. "Nga qeveria e kaluar ka qenë një draftligj ku buxheti është menduar të jetë 2.4 miliardë euro. Tani Ministria e Financave bashkë me organizatat buxhetore të tjera janë duke i shikuar mundësitë e rritjes, megjithatë mbetet të shihet sesa do të jetë kjo shifër", thotë Shahini.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tanimë ka premtuar që buxheti i Kosovës do të arrijë në vlerën 3 miliardë euro gjatë qeverisjes katërvjeçare.

Vonesat e krijuara për miratimin e buxhetit për vitin 2020, sipas përfaqësuesve të bizneseve, kanë dëmtonuar afaristët.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se asnjë projekt i ri kapital i qeverisë nuk ka mundur të fillojë së zbatuari për shkak të mungesës së miratimit të buxhetit me kohë dhe si pasojë edhe disa biznese kanë ndalur së vepruari. "Mosmiratimi i buxhetit nga Qeveria e Kosovës është pengesë e madhe dhe po promovon pasiguri për investime pasi që të gjitha projektet që është dashur të financohen janë ndalur dhe bizneset nuk investojnë në projekte të cilat në një mënyrë janë të ndërlidhura me buxhetin e shtetit. Gjithë kjo vonesë që po ndodh po promovon paaftësi dhe pasiguri. Sa më shpejt që qeveria e re ta miratojë buxhetin aq më shumë do të ketë

mundësi për investime në projekte të ndryshme të cilat gjenerojnë edhe vende pune", thotë ai.

Përgjatë viteve në qeveritë e kaluara përçindja më e madhe e buxhetit të Kosovës ishte ndarë për projektet në infrastrukturë rrugore, siç kanë qenë autostrada që lidhi Kosovën me Shqipërinë dhe autostrada që lidhë Kosovën me Maqedoninë e Veriut. Investime të shumta ishin përqendruar edhe në ndërtimin e rrugëve lokale e magjistrale.

Investimet e mëdha të bëra në infrastrukturë në vazhdimësi ishin kritikuar nga organizatat ekonomike pasi, sipas tyre, ndonëse ndërtimi i rrugëve është i domosdoshëm, nuk gjeneron vende të shumta të punës. Qeveria e kaluar ishte kritikuar edhe për mungesë të menaxhimit të duhur të mjeteve buxhetore.



## Kontrabanda në veri, kapën mbi 8 500 litra pije joalkoolike

MITROVICË, 4 MARS (ER) - Dogana e Kosovës ka bërë me dije se oficerët doganorë, respektivisht njësitë anti-kontrabandë, gjatë patrullimeve rutinore në veri të Mitrovicës kanë kapur një maune, e cila kishte sasi të konsiderueshme të pijeve joalkoolike mbi 8 500 litra. "Oficerët doganorë gjatë

patrullimeve kanë vërejtur një maune të parkuar. Dyshimet e para ishin se ngarkesa përmbante mallra të kontrabanduara. Pas hapjes së maunës janë gjetur sasi e konsiderueshme e pijeve joalkoolike në sasi prej 12 paleta x 90 pako x 24 copë = 25,920 copë x 0.33 litra, gjithsej 8 553

60 litra. Mauna dhe sasia e mallrave të kontrabanduara janë konfiskuar edhe është hapur rasti për hetime të mëtejme. Dogana e Kosovës fton qytetarët që të thërrasin në 0800 50095 për raste të dyshuar të kontrabandës dhe korrupsionit", ka njoftuar Dogana e Kosovës.



## Gjilani nënshkruan marrëveshje për përmirësimin e cilësisë së arsimit

**GJILAN, 4 MARS (ER)** - Drejtoria Komonale e Arsimit në Gjilan ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Caritasin zviceran në Kosovë për implementimin e projektit "Vendosja e standardeve parashkollore të cilësisë së lartë duke përfunduar arsimin, shkencën dhe ekonominë-Shpresë". Kjo marrëveshje është nënshkruar drejtori i Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica dhe drejtori i Caritasit zviceran për Kosovë, Kreshnik Basha.

Marrëveshja në fjalë ka për

qëllim që ta përmirësojë cilësinë e arsimit dhe ofrimin e shërbimeve në nivelin e arsimit parafillor në Komunën e Gjilanit përmes përmirësimit të shërbimeve të qëndrueshme për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të edukatorëve parafillorë në nivel komunal si dhe duke krijuar një mjedis miqësor ndaj fëmijëve në klasat e arsimit parafillor.

Ky projekt përfshin organizimin dhe ofrimin e trajnimit për edukatorët ekzistues të

nivelit parafillor dhe zyrtarëve në Komunën e Gjilanit, organizimin e sesioneve për monitorim të cilësisë dhe mentorim për edukatorët e trajnuar parafillorë, mobilizimin e pikave përkatëse kontaktuese për arsimin në nivel komunal, avokimin në nivel komunal për arsimimin e mëtejshëm të edukatorëve në arsimin parafillor, sikurse edhe ofrimin e pajisjeve dhe materialeve didaktike për pesë klasat e përzgjedhura.



## Kryetari Jashari kërkon përkrahje nga ministri Abdixhiku për Skenderaj

**PRISHTINË, 4 MARS (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është takuar me ministrin e Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të cilin e ka uruar për pozitën e re si dhe ka kërkuar nga ai përkrahje për Komunën e Skenderajt në rregullimin e infrastrukturës dhe mbrojtjen e ambientit.

"Biseduam për bashkëpunimin për realizimin e projekteve të përbashkëta, për rregullimin e infrastrukturës rrugore, për shtretërit e lumenjve, për projekte të gjelbërimit, për kanalizimin, për planifikimin hapësinor etj", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari Jashari.

## Në vitin 2019 në Mitrovicë janë realizuar 287 ndërmjetësime të rregullta në punë

**MITROVICË, 4 MARS (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i shoqëruar nga drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin e Zyrës Rajonale të Punësimit në Mitrovicë, Besmir Salihun. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i raportit vjetor për realizimin e aktiviteteve në Zyrën e Punësimit si dhe për mundësinë e bashkëpunimit ndër institucional në

shërbim të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës.

Me këtë rast, drejtori Salihu ka theksuar se gjatë vitit 2019 kanë realizuar gjithsej 287 ndërmjetësime të rregullta në punë dhe mbi 400 të ndërmjetësuar në Zyrën e Punësimit përmes Programeve Aktive të Tregut të Punës. Po ashtu, ai ka përmendur disa nga projektet që janë realizuar në vitin paraprak, në të cilat ka qenë e përfshirë edhe komuna.



## Komuna e Prishtinës dhe TIKA Kosova nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

**PRISHTINË, 4 MARS (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje mirëkuptimi me TIKA Kosova me qëllim të bashkëpunimit për seminare të edukimit special. Sipas një njoftimi të Komunës së Prishtinës, Programi i Certifikuar të Trajnimit për Praktikusit e Analizës së Sjelljes së Aplikuar (Applied

Behavioral Analysis -ABA) është duke filluar për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në seminare të edukimit special të mbajtur vitin e kaluar dhe të cilët kanë fituar të drejtën për t'u pajisur me certifikatë të pjesëmarrjes për këtë çështje.

Komuna e Prishtinës ka falënderuar TIKA Kosova për mbështetjen e vazhdueshme.



## Në Prizren organizohet punëtorja për trajnimin e stafit të legalizimit të ndërtimeve pa leje

**PRIZREN, 4 MARS (ER)** - Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Prizrenit, e mbështetur nga stafi profesional i Ministrisë së Infrastrukturës dhe

Ambientit, si dhe përfaqësues të Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), të mërkurën ka organizuar një punëtorë për trajnimin e stafit të legalizimit të ndër-

timeve pa leje. Në këtë punëtorë ishte i pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Memaj, i cili me këtë rast shprehu mirënjohjet e

tij për ministrinë dhe USAID-in për mbështetjen e tyre.

Trajtimi dhe shqyrtimi i lëndëve për legalizim do të fillojë nga fillimi i javës së ardhshme.



# Gabimet e politikës shtetërore ndaj turizmit në Kosovë (2)



Shkruan: Erzen GJONBALAJ

Sikur të jetësohej ky program sigurisht se rrjedhja e aktiviteteve turistike do të kishte kahe tjetër dhe nuk do të ndodhnin disa veprime të pamatura të kreut të këtij institucioni - MTI-së në vazhdimësi, asnjë nga ekipet që ndërrohen me ndërrimin e pushtetit nuk mund të lavdërohen që bën diçka të mirë në fushën e turizmit që do të mbahej mend. Realizimi i këtij plani do të mundësonte që njëra nga pjesët më atraktive turistike të vihet nën kontrollin e këtij departamenti dhe qeverisë për çka është dashtë mobilizimi i pushtetit që Brezovica të frymojë ndryshe, që pushteti nga Prishtina ta shtrijë aktivitetin në tërë territorin e saj.

Dikush do të thotë se këto janë ëndrra por me sakrificë, çdo ide bëhet realitet.

Jetësimi i këtij plani do të mundësonte një zhvillim të hovshëm të turizmit rural ashtu si po veprohet në vendet e rajonit ku turistët kosovarë janë vizitor të rregullt, do të zbatohet një plan i periudhës së Ylli

Pangos kur ishte në krye të turizmit shqiptar duke kopjuar projektin "Dyzet hanet e turizmit shqiptar" kur viset dikur më të prapambetura në Alpet Shqiptare të pjesës së Shqipërisë sot janë plot gjallëri të cilat po valorizohen gjithnjë e më sukses. Njëra nga dështimet kryesore të politikës së deritanishme e cila ka të bëjë me drejtimin e turizmit është shndërrimi gjegjësisht degradimi i organit qeveritar - Departamenti i Turizmit dhe Hotelierisë në divizion - turizmi dhe hoteliera. Në momentin kur industria e turizmit shënon rritje të vazhdueshme në të gjitha rajonet turistike botërore dikujt i bie ndërmend dhe vendos përmes një akti të shëmtuar që në vend që ta ngrit këtë departament, bënë degradimin e tij në një nivel të njësisë të shërbimit të sigurimit të objektit të ministrisë.

Tjetër dështim në politikat turistike të Kosovës ishin edhe disa fantazma rreth investimeve qindra milionëshe në kompleksin turistik Brezovica. Për ata që nuk e kuptojnë politiken Brezovica paraqet "zorrën qorre" të turizmit kosovar. Duke ditur rolin e zorrës qorre në organizmin e njeriut, e cila çdo herë paraqet rrezik për shëndetin e njeriut ashtu edhe Brezovica me statusin e tanishëm kurrë nuk është e sigurt sepse asaj iu ka dhënë një status çka s'është dashur ta ketë dhe e njëjta çdoherë paraqet

mjedis turbulent për investitorët e mundshëm dhe e njëjta duhet të vihet nën pushtetin e Prishtinës. Kur mendojmë për investime në Brezovicë ato mund të jenë për momentin vetëm material propagandues politik, çka u tregua edhe me investitorët fantazmë francez vite më parë.

Mungesa e ideve dhe sinqeriteti kanë bërë që potencialet turistike më kryesore të Kosovës deri tani të mbeten në harresë dhe të njëjtat as që janë përmendur ndërsa në disa hulumtime të OSBE-së dhe hulumtuesve shkencorë nga fusha e gjeografisë del se Alpet Shqiptare apo të njohura si Bjeshkët e Nemura, në dy anët e kufirit të Kosovës (kryesisht territori i Komunës së Deçanit dhe Junikut) dhe i Malit të Zi (Komuna e Plavës) kanë potenciale turistike për zhvillimin e turizmit dimëror gjegjësisht të sporteve dhe "kënaqësive" dimërore më shumë se territori i Sllovenisë dhe pjesa tjetër e Malit të Zi së bashku. Nëse u referohemi këtyre të dhënave del se në Bjeshkët e Nemura - Alpet Shqiptare në të njëjtën kohë mund bëjnë gara sportive dimërore, kënaqësi në rrëshqitje në dëborë rreth 100.000 skijator apo nëse e zbërthejmë këtë në standardin që një skijator është i barabartë me dy shtretër, del se potenciali turistik ka kapacitet që të ndërtohen 200.000 shtretër apo nëse e marrin ½ e këtyre

mundësive del se Kosova në momentin ka kapacitet vetëm në Alpet Shqiptare 100.000 shtretër, ku ndoshta humbja e territorit do t'i ulte pak këto mundësi, por megjithatë mbetemi në shpresë se pushteti në të ardhmen do të kthejë mendjen nga kjo pjesë dhe të gjejë mënyrën dhe mjetet që të valorizohen këto resurse të cilat më të vërtet mbajt titullin e "bukurisë së egër". Rruga Deçan-Plavë që po pritet me gëzim nga dy anët do të jetë katalizatori kryesor që këto pjesë të paprekura të bukuri natyrore të marrin vlerën e merituar por e tëra varet nga pushteti - politika e cila në të kaluarën u tregua si pengës në mosvalorizimin e shumë potencialeve turistike të Kosovës.

Është për t'u habitur si në analizën e situatës aktuale në sektorin e turizmit në Kosovë të nxjerr nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar - Sida në vitin 2018 nuk përmendet potenciali i Alpeve Shqiptare.

Sipas të dhënave disponuese shohim se Qeveria ka kthyer sërish Departamentin e Hotelierisë dhe Turizmit si njësi organizative në kuadër të MTI-së por për fat të keq në të dy rastet e kërkimit për drejtor të këtij departamenti në atë intern dhe atë të jashtëm nuk u gjet njeri i cili kishte ato cilësi çka kërkohet për kreun e këtij departamenti. Këtu paraqitet ai problemi të

cilin e sugjeron Hese se a nuk ka njerëz të përgatitur për të udhëhequr fenomenin dhe aktivitetet e turizmit apo politika paraqitet pengës sepse nuk e do "atë" që nuk është i tyre.

Nuk mund të thuhet se në Kosovë nuk zhvillohet turizmi. Turizmin e zhvillojnë individët (ndërmarrësit), ekonomitë familjare, grupet e ndryshme por mungon menaxhimi institucional i turizmit sikur ngjan në shumicën e vendeve botërore.

Dështimet janë të panumërta por "faji është jetim", megjithatë mbetemi me shpresë që do del dikush ndoshta nga pushteti i ardhshëm cili do të lë anash interesin partiak dhe duke formuar një ekip këshillues të ekspertëve të provuar në fusha të caktuara të cilët do të jetë në gjendje të gjejnë shanset e turizmit të Kosovës dhe të ta vazhdojnë punën aty ku e filloj ministri i parë dhe më i suksesshmi sa i përket çështjes së turizmit prof. i ndjerë Ali Jakupi.

Shumica e fenomeneve dhe aktiviteteve zakonisht zhvillohen duke u mbështetur në mite. Kosova për fat të keq nuk i ka identifikua ende këto mite dhe sa po shihet po zbaton një mit sa i përket turizmit: Kosova nuk ka det, prandaj nuk i duhet as turizmi.

(Autori është turizmolog-hulumtues i turizmit erotik dhe turizmit rural. Fund)



Peizazhi i bukurive natyrore të Alpeve Shqiptare, pika e tretë e kufirit (KS - AL -MNE). Natyra i dhuroi këto bukuri të cilat njeriu nuk po mund t'i valorizojë. /Foto 08.02.2020. Enes Psk Hrid Drešković)

Me rastin e 22-vjetorit të rënies heroike të nxënësve  
nga okupatori serb, në altarin e lirisë



**VALDETE (RIFAT) JASHARI**  
27.07.1983-05.03.1998  
Kl. VIII-1



**LIRIJE (HAMZË) JASHARI**  
13.10.1983-05.03.1998  
Kl. VIII-1




**KUSHTRIM (ADEM) JASHARI**  
23.04.1984-05.03.1998  
Kl. VI-4



**IGBALLE (RIFAT) JASHARI**  
13.03.1987-05.03.1998  
Kl. IV-1



**IGBALL (RIFAT) JASHARI**  
25.02.1984-05.03.1998  
Kl. VI-4



**FATIME (HAMZË) JASHARI**  
27.04.1989-05.03.1998  
Kl. II-1



**BUJAR (ZENË) JASHARI**  
10.10.1987-05.03.1998  
Kl. IV-4



**BLERIM (HAMZË) JASHARI**  
08.10.1985-05.03.1998  
Kl. V-4




**BLERINA (HAMZË) JASHARI**  
1991-05.03.1998  
PARASHKOLLOR

**U rilindët së bashku me lirinë e Kosovës!**

*Me dashuri dhe mall, ju përkujtojnë nxënësit dhe mësimdhënësit e  
shkollës "Shaban Jashari"- Skenderaj*

Me rastin e njëzetë e dy vjetorit të rënies heroike të mësuesit  
dhe heroit kombëtar Shaban Jashari!



## **SHABAN JASHARI**

(1924 – 1998)

Madhështia e veprës sate, bac Shabani, qëndron në atë  
se si përjetësohet liria!

*Me plot dashuri dhe nderim, ju përkujtojnë nxënësit dhe mësimpldhënësit e shkollës  
“Shaban Jashari” në Skenderaj.*

## Netanyahu nuk siguron shumicën në parlament

TEL-AVIV, 4 MARS - Blloku i krahut të djathtë i kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, duket se ka dështuar ta sigurojë shumicën në parlament, pas zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura të hënën. Pas 99 për qind të votave të numëruara, Partia Likud e Netanyahu pritët të fitojë 36 ulëse, derisa

partitë aleate fetare 22 ulëse tjera.

Ky rezultat nënkupton se atyre iu mungojnë tri ulëse për të pasur shumicën në parlamentin me 120 deputetë.

Partia rivale e Netanyahu, Blu dhe Bardhë, parashikohet se do të fitojë 33 ulëse.

Të hënën janë mbajtur zgjedhjet e treta në Izrael në më pak

se një vit.

Asnjëri prej liderëve të partive nuk ka arritur të fitojë shumicën as në dy proceset e kaluara zgjedhore.

Netanyahu, 70-vjeçar, është kryeministri që ka qëndruar më së gjati në pushtet në Izrael.

Ai është duke synuar të fitojë një mandat të pestë, pasi ka

qenë në pushtet nga viti 1996 deri më 1999 dhe sërish nga viti 2009.

Përgjatë fushatës, ai e ka prezantuar veten si kandidatit e vetëm që mund të garantojë sigurinë e shtetit, pavarësisht pse do të përballet me gjyq, pas akuzave për korrupsion, të cilat ai i konsideruar të motivuara politikisht.



# Joe Biden afër nominimit për president në radhët e demokratëve

Ish-nënpresidentin amerikan Joe Biden fitoi në nëntë shtete, përfshirë edhe Teksasin, ku fitorja e tij ishte befasi meqë anketat e hershme e nxirrnin Sandersin si kryesues dhe, pas tërheqjes nga gara të kandidatët Michael Bloomberg, Biden është afër nominimit për president



WASHINGTON, 4 MARS - Kandidati demokrat për president Michael Bloomberg njoftoi të mërkurën se tërhiqet nga gara për ta kërkuar emërimin e Partisë Demokratike si kandidat presidencial dhe se do ta mbështesë kandidatin Joe Bidenin. Njoftimi vjen ndërkohë që gara në Partinë Demokratike është konsoliduar: nga një konkurrencë mes më shumë se 20 kandidatëve në atë mes vetëm dy prej tyre, pas rezultateve të mira të së martës për ish-nënpresidentin Joe Biden dhe senatorin nga Vermonti, Bernie Sanders.

Joe Bideni fitoi në nëntë shtete, përfshirë edhe Teksasin, ku fitorja e tij ishte befasi meqë anketat e hershme e nxirrnin

Sandersin si kryesues. Ai doli shumë mirë kudo në jug, duke fituar në Virginia, Karolinën e Jugut, në Alabama, Oklahoma, Tennessee dhe Arkansas sikurse edhe në Minnesota dhe Massachusetts.

Bernie Sanders fitoi në Kaliforni, në Kolorado, në Utah si dhe në Vermont.

Të mërkurën në mëngjes ende nuk ishte e qartë se cili mund të ketë fituar në Maine.

Të martën në 14 shtete të ShBA-së janë mbajtur zgjedhjet paraprake për kandidatin e Partisë Demokratike. Bloomberg ka arritur të fitojë vetëm në Samoan amerikane, ndërsa Biden ka fituar në nëntë shtete. Ky i fundit fitoi nëntë nga 14

shtetet që votuan për të zgjedhur kandidatin demokrat për shtëpinë e bardhë në atë që njihet si super e marta.

Ish-zëvendëspresidenti amerikan, arriti madje të përmbyste parashikimet duke ia rrëmbyer shtetin kyç të Teksasit, rivalit të tij kryesor

Bernie Sanders. Sidoqoftë ky i fundit parashikohet të fitojë Kaliforninë, një tjetër çmim i madh në garë.

Partia Demokratike do ta zgjedhë në verë kandidatin e saj që do të sfidojë presidentin aktual, Donald Trump, në zgjedhjet e nëntorit. Aktualisht,

më të pëlqyerit janë Joe Biden dhe Bernie Sanders.

Më shumë se 1300 delegatë përcaktohen në votimet paraprake të Super të Martës, pra rreth një e treta e delegatëve që do të marrin pjesë në Konventën Kombëtare Demokratike që mbahet në verë.

## Koronavirusi merr jetën e 107 personave në Itali



ROMË, 4 MARS - Në Itali numri i të vdekurve për shkak të koronavirusit ka shkuar në 107. Ndërkohë që numri i të infektuarve është 2706. Krahasuar me ditën e djeshme, janë 443 persona më shumë të infektuar dhe 28 persona të vdekur.

Autoritetet italiane vazhdojnë që

të jenë vigjente dhe të aplikojnë masa me qëllim që të shmangin edhe më shumë përhapjen.

Qeveria vendosi që të mbyllë shkollat dhe universitetet deri më 15 mars, ndërkohë që takimet e Serisë A do të luhet me dyer të mbyllura.

Ndërkohë që epidemia e koronavirusit ka shkaktuar dëme

të mëdha ekonomike në Itali.

Koronavirusi pritët t'i kushtojë sektorit të turizmit në Itali 7,4 miliardë euro humbje në tremujorin e ardhshëm, nga 1 marsi deri në 31 maj, me një humbje prej mijëra turistësh, njoftoi konfederata që përfaqëson bizneset "Confturismo-Confcommercio".

## Partia OLaNO ngarkohet me formimin e koalicionit qeveritar në Sllovaki

BRATISLAVË, 4 MARS - Presidentja e Sllovakisë, Zuzana Caputova, udhëzoi të mërkurën zyrtarisht Igor Matoviqin, liderin e partisë antikorruption të qendrës së djathtë, OLaNO, i cili fitoi zgjedhjet parlamentare, për të formuar një qeveri koalicioni.

OLaNO hoqi nga pushteti koalicionin e drejtuar nga partia populiste e së majtës, Smer, duke përdorur zemërimin e votuesve për vrasjen e gazetarit investigativ Jan Kuciak, në 2018, i cili kishte bërë hetime për korrupsionin e shfrenuar

në këtë vend të eurozonës.

"Unë i kam besuar kryetarit të partisë OLaNO, Igor Matoviqit, formimin e një qeverie", tha për mediet presidentja liberale, Zuzana Caputova, gjatë një ceremonie zyrtare në Bratislavë. Matoviq tha se dëshiron ta për-

fundojë sa më shpejt që të jetë e mundur formimin e një koalicioni prej katër partive të fortë të qendrës së djathtë me 95 vende në parlament, nga 150 që janë, një shumicë kjo që do ta lejonte të ndryshonte kushtetutën.



# Kompozoi për sot, çka vjen pas s'më intereson aspak!



*Kurt Weill me gruan e tij Lotte Lenya (Nju Jork, 17 gusht 1942)*

**Nga: Rick FULKER**

“Secila vepër e tij ishte një model i ri, një formë e re, një zgjidhje e re”, shkruante kompozitori Virgil Thompson në nekrologjinë për Kurt Weillin, i cili ndërroi jetë nga një infarkt kardiak në vitin 1950, pak pasi kishte mbushur 50 vjeç. Fjalët e Thompsonit flasin për dy cilësi të Weillit: shumëllojshmërinë stilistike dhe pasionin për inovativen. Kompozitori i “Opera për tre groshë” (Dreigroschenoper) shkroi forma të ndryshme, si kantata radiofonike, një operë me muzikë popullore, apo një operë shkollore – përveç veprave të tij të shumta në zhanre konvencionale, një koncert për violinë, këngë artistike, muzikë dhome dhe shumë të tjera.

Festivali i 28-të Kurt-Weill, në qytetin e tij të lindjes në Desau, ndjek gjurmët e kompozitorit dhe veprës së tij çuditërisht heterogjene, nga data 28 shkurt deri me 15 mars, në 53 evente artistike. “Çfarë janë kufijtë?”, është motoja e këtij viti, që i

referohet emigrimit të detyruar të Kurt Weill nga Gjermania në vitin 1933, por edhe veprës së tij, që nuk njeh kufij dhe u reziston shablloneve dhe kategorive.

Kurt Weill hyn tek ata artistë të cilët gëzojnë një status shumë më të lartë në të gjithë botën, sesa në vendlindjen e tyre. I lindur në vitin 1900 si djali i një drejtuesi kori në një sinagogë në Desau, Weill e mëson artin e tij muzikor në Berlin tek kompozitori Ferruccio Busoni. Në vitet 1920, krijoi së bashku me poetin dhe shkrimtarin Bertolt Brecht, kryevepra si “Opera për tre groshë” dhe “Ngjitja dhe rënia e qytetit Mahagonny”. Në vitin 1933, hebreu Weill emigron në Paris, dy vjet më vonë shkon në Nju-Jork së bashku me të shoqen, këngëtarën Lotte Lenya, dhe bëhet shtetas amerikan.

Më vonë emigranti refuzon të flasë “në gjuhën e keqbërësve”, madje as me gruan e tij nuk fliste më gjermanisht. U bë kompozitori më i suksesshëm në Broadway, nga pena e tij dolën opereta si “Street Scene”, “Lady in the Dark” apo “One

Touch of Venus”. Ishte nga të paktët krijues të tingullit, meloditë e të cilit, si “Kënga e Mackie” apo “September song”, shumë njerëz i njohin pa ditur të thonë autorin.

“Kurt Weill e sakrifikoi kreativitetin e tij për shijen e publikut, duke u shitur te biznesi i teatrit amerikan”, shkruante filozofi dhe muzikologu Theodor W. Adorno në vitin 1950 në një nekrologji për Weillin. Një biograf i hershëm shprehej kështu: “Ai i ndryshonte stilet, më shpesh se ç’ndërronte vendet”, dhe nuk e mendonte aspak si kompliment.

Për Kurt Weillin është debatuar gjatë dhe fort, pikërisht për shkak të suksesit të tij në atdheun e ri. Në kontinentin e vjetër Evropë, në vitet e para të pasluftës, impakt mbi stilin kishte muzika serioze avangarde, një stil që nuk kishte të bënte aspak me operetat.

Ndryshe është tani 120 vjet pas lindjes dhe 70 vjet pas vdekjes së tij. “Unë besoj se Weill është në ngjitje”, tha Jan Henric Bogen, drejtori i festivalit Kurt-

Weill në Desau. “Edhe veprat e tij amerikane po vihen gjithnjë e më shumë në skenë në Gjermani. Vepra si ‘Street Scene’ ‘Silbersee’ (Liqeni i argjendtë) janë përsëri aktuale”. “Shkaqet të bëjnë nganjëherë të mendosh”, thotë Bogen, sepse “rrethanat në të cilat u krijuan veprat përsëriten. Ne shohim se nacionalizmi dhe populizmi po rishfaqen sërish dhe kjo është arsyeja përse ne tani mund të identifikohemi më fort me veprat e Kurt Weillit”.

Historia nuk përsëritet vetë, thotë një fjalë popullore, por ajo rimon. Weill, i cili në veprat e tij të hershme në Gjermani përdorte suingun dhe ritmin e stileve të kërcimit amerikan, i mori këto eksperiencia me vete në bagazh, për ta rigjetur veten më vonë në operetat në Broadway. “Ai iu përshtat rrethanave, por në kuptimin më të mirë të fjalës”, thotë Jan Henric Bogen, “duke i marrë impulset e reja artistike si burim frymëzimi. Kjo është veçoria, që e bën aq tërheqëse të merresh me të”.

Interesimi aktual për veprat e tij

të bën edhe më shumë përshtypje, po të kujtosh një fjalë të tij: “Sa për mua, unë kompozoi për sot. Çfarë vjen pas, s’më intereson aspak.”

Por, pasardhësit interesohen për Kurt Weillin. Popullariteti i vazhdueshëm kuptohet më mirë me këtë citat nga viti 1936: “Skena sot ka të drejtën të ekzistojë, vetëm nëse përpiqet të arrijë një nivel më të lartë të së vërtetës”. Kjo nxjerr në pah “klasiken” në veprën e Weillit, në kuptimin më të mirë të fjalës, ashtu si dhe një citat tjetër i Weillit: “Unë kurrë nuk e kam njohur dallimin mes muzikës ‘serioze’ dhe asaj ‘të lehtë’. Ka vetëm muzikë të mirë dhe të keqe”.

Atdhetari amerikan i sapombërritur, që mbështeti atdheun e tij të ri në luftën kundër Gjermanisë, ka thënë një herë edhe fjalë, që nuk mund të ishin larg retorikës së qeverisë së atëhershme amerikane. “Ata që vijnë këtu në kërkim të lirisë, drejtësisë, mundësi të reja dhe dinjitetit njerëzor, gjëra që u mungojnë në vendin e tyre, janë amerikanë që përpara se të arrijnë këtu”. /DW/

E jashtëzakonshme

# E ujiti lulen për dy vjet, gruaja tregon se si e kuptoi se ishte prej plastike



Caelie Wilkes, një grua nga Kalifornia, kishte ujitur një lule për dy vjet, ndërsa më vonë e kuptoi se ishte plastike. Sipas mediave të huaja,

ajo kishte publikuar "mjerimin" e saj në llogarinë e saj në "Facebook". "Ndihehem sikur këto dy vjetët e fundit kanë qenë një gënjeshtër për mua",

ka shkruar Wilkes. Ajo rastin e kishte zbuluar krejt rastësisht kur u përpoq ta ndërronte vazon e saj, teksa aty pa që ajo në të vërtetë ishte e rreme.

FOTO E DITES



Një migrant shihet i mbështjellë me një batanije afër kufirit turko-grek. /AP/

E rrallë

# Historia e gurëve 4 000-vjeçarë në Spanjë, ishin të 'varrosur' nën ujë, por u shfaqën papritur



Mendohet se ishin më shumë se 4000 vjet të vjetër, gurët 'Dolmen i Guadalperal' ishin të 'padukshëm' për gati 60 vjet derisa u shfaqën papritur. Evropa pësoi një verë jashtëzakonisht të nxehtë në vitin 2019. Kushtet e ngrohta

atmosferike zbuluan një pamje të papritur në provincën e Caceresit, pasi thatësira bëri që të tërhiqet vija bregdetare e lumit Tagus, ndërkaq një monument rreth 4,000-7000 vjeçar doli në mes të rezervuarit të Valdecanas.

## BARSOLETA E DITËS



- Ben, pse ia ke vënë vajzës emrin si të gruas?  
- Mira, o Mira... ma sill një birra!  
Pas pak sekonda vijë dy birra.  
- Ja pra mik, e kuptove?



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D


Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p><b>DASHI</b> Karma e mirë do të vijë patjetër në rrugën tuaj dhe ju mund të prisni disa dhurata shpërblyese.</p>	 <p><b>DEMI</b> Nëse keni menduar të bëni një blerje, shikoni për ofertat më të mira. Mos shkoni për atë që ju reklamohet më shumë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Ju mund të jeni duke luftuar me një situatë të ndërlikuar tani, ndaj është me rëndësi që të merrni sa më shumë informacion.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Për të arritur atje ku doni sa më shpejt në karrierën tuaj, duhet t'i ekulibroni aftësitë tuaja.</p>	 <p><b>LUANI</b> Të mësoni diçka të re është e pamundur nëse mendoni se i dini të gjitha, prandaj sigurohuni që ta ruani përulësinë.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Çdo problem që ju keni me bashkëpunëtorët tani mund ta bëjë ditën e punës më të pakëndshme, por ato janë të pashmangshme.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një aktivitet shoqëror mund t'ju shkaktojë lodhje. Nëse nuk dëshironi të merrni pjesë, gjeni një justifikim për ta anuluar pjesëmarrjen.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Dikush për të cilin keni interes ose ju pëlqen mund të bëjë diçka që ju shqetëson vërtet sot, por ju do të duhet të bëni çmos për të mos u zemëruar me atë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Kjo është një ditë e shkëlqyer për të bërë shumë gjëra dhe të argëtoheni ndërsa e bëni këtë! Koha është në anën tuaj tani.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Nëse një marrëdhënie e re që ka nisur së fundmi është duke ecur mirë, përpuni ta ruani dhe ta forconi atë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot mund të shënohet fillimi i diçkaje të re për ju. Vazhdoni të bëni atë që jeni duke bërë dhe mos harxhoni shumë energji duke kërkuar diçka të re.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Energjia juaj është e lartë sot, por pak eksplorim do ta bëjë atë edhe më të fortë! Proveni të bëni diçka të re sot.</p>



## Trumpi e fton Kim Kardashianin në Shtëpinë e Bardhë



**P**residenti amerikan Donald Trump do të takohet me yllin televiziv Kim Kardashian në Shtëpinë e Bardhë për ta tërhequr vëmendjen për

reformën e drejtësisë penale. Kardashian do të shoqërohet nga ish të burgosurit Tynice Nichole Hall, Crystal Munoz dhe Judith Negron.

## Harry i mirëpritur në familjen mbretërore nëse vendos ta marrë sërish titullin e lartë



**L**argimi i Princit Harryt dhe Meghan Markle nga detyrat e tyre nuk është përfundimtar, pasi çifti mund të kthehet në çdo çast nëse ndryshojnë mendje. Vetë mbretëresha Elisabetë ia ka komunikuar këtë vendim nipit të saj, në një bisedë të gjatë që kanë zhvilluar së bashku. Princi Harry do të jetë gjithmonë i mirëpritur në famil-

jen mbretërore nëse ai vendos ta marrë sërish titullin e lartë. Vetë mbretëresha mësohet se ia ka komunikuar këtë vendim nipit të saj, pas një takimi katër orësh, në kështjellën Windsor. Princi Harry dhe Meghan Markle do ta nisin jetën e tyre të re në Amerikën e Veriut në fund të muajit mars dhe do të jenë të pavarura financiarisht.



## Rita Ora sfilon për Miu Miu në Javën e Modës në Paris

**R**ita Ora mund t'i bëjë të gjitha. Këngëtarja e "Girls" ka marrë gjithë vëmendjen kur në ditën e fundit të Javës së Modës në Paris ka sfiluar në pasarelën e Miu Miu. "Vajza juaj sfiloi sot. Është një nder i

jashtëzakonshëm të sfiloj për ty Muccia Prada Miu Miu. Është fantastike të punosh me një ekip fantastik dhe padyshim se të gjitha vajzat më ndihmuan. Faleminderit!", ka shkruar Ora në "Instagram".

## Beckhami frikësohet nga Bieberit



**D**avid Beckhami është frikësuar nga Justin Bieberit. Ish-ylli i futbollit ishte i ftuar në emisionin e Ellen DeGeneres. Gjatë paraqitjes së tij, ai foli rreth vajzës së tij tetëvjeçare Harper dhe se si djali i tij 15-vjeçar, Cruz, po fillon të luajë në mandolinën që ia

bleu për 14 dollarë. David, po ashtu, foli edhe rreth pjesëmarrjes si mysafir në serialin "Modern Family" dhe zbuloi se nuk e ka në plan ta eksplorojë aktrimin si karri-erë. Pas kësaj, ai po tregonte për lojërat që i zhvillonin në shtëpinë e Justin Bieberit dhe në atë çast këngëtarja kërcëu jashtë kutisë dhe

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

# Ballkani 'fik' Dritën, Gjilani dhe Prishtina kundërpërgjigjen me fitore



Ballkani e ka fituar derbin ndaj Dritës dhe në këtë mënyrë e ka ruajtur pozitën e parë në elitë. Me fitore u janë kundërpërgjigjur suharekasve Gjilani dhe Prishtina, që kanë tri pikë më pak

**EPOKA E ENJTE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 MARS - Skuadra lidere e IPKO Superligës në futboll, Ballkani, ka treguar se nuk është rastësish në pozitën e parë, pasi të mërkurën e ka fituar derbin ndaj Dritës me rezultat 2-0. Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në Suharekë u mbyll me rezultat 0-0, kurse në pjesën e dytë vendësit ishin më të mirë dhe arritën të shënojnë dy gola për tri pikë të arta në garën për titull.

Në minutën e 75-të Blend Baftiu realizoi për 1-0, kurse shtatë minuta më vonë Edvin Kuq e vulosi rezultatit final 2-0. Pas kësaj ndeshje Ballkani ka grumbulluar 44 pikë, kurse Drita bie në pozitën e katërt dhe mbetet në kuotën e 40 pikëve.

Me fitore është kundërpërgjigjur skuadra e Gjilanit, e cila e mposhti kampionin në fuqi të Superligës, Feronikelin (2-1). Fiton Hajdari pati formë të lartë në këtë ndeshje dhe ishte më meritori për tri pikët e fituara ndaj "Niklit", pasi shënoi dy golat e fitores, derisa për mysafirët nga Drenasi realizues i vetëm ishte Albert Dabiqaj. Gjilani kishte edhe një mundësi të shënojë nga penalltia në pjesën e dytë, por Busiq dështoi përballë portierit Troshupa. Pas kësaj fitore Gjilani e rremben pozitën e dytë dhe ka 41 pikë, kurse "Nikli" është në pozitën e pestë

me 31 pikë.

Fitore shumë të rëndësishme në garën për titull në Superligë ka shënuar edhe Prishtina. Kryeqytetasit në stadiumin "Fadil Vokrri" të mërkurën e mposhtën Ferizajn (3-2). Mysafirët janë mbajtur vetëm deri në fund të pjesës së parë kur për 1-0 shënoi Ahmed Januzi. Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë realizoi edhe në fillim të pjesës së dytë para se Otto John ta shtojë epërsinë e Prishtinës në 3-0. Dhjetë minuta para fundit, Ferizaj e shënoi golin e parë nëpërmjet Albin Krasniqi, kurse më pas shënoi edhe Taulant Dajaku dhe ndeshja u mbyll me shifrat 3-2. Prishtina ngritet në pozitën e tretë me 41 pikë, kurse Ferizaj është në vendin e dhjetë me 22 pikë. Fitore ka shënuar edhe Llapi i Tahir Batatinës, i cili u tregua një klub i madh për faktin se fitoi me përmbysje ndaj Trepçës '89 (1-2). Klubi nga Mitrovica e mbylli pjesën e parë në epërsi të një goli që u realizua nga Arb Manaj, por llapjanët në pjesën e dytë ishin më të mirë dhe shënuan dy gola nëpërmjet Erlis Ymerit dhe Egzon Krasniqit për t'i marrë pikët e plota nga kjo ndeshje.

**Besa fiton derbin ndaj Arbërisë, mposhtet Malisheva**

Besa e Pejës vazhdon të përforcohet në pozitën e parë në renditjen tabelore të Ligës së Parë. Pejanët sot e mposhtën

në derbi Arbërinë me rezultat 2-0 dhe tash kanë grumbulluar 37 pikë. Pavarësisht prej humbjes, Arbëria mbetet në pozitën e dytë me 33 pikë. Humbje të papritur në këtë xhiro ka pësuar edhe Malisheva, e cila si vendëse u mposhtë nga Dardana (1-2). Ndërsa Liria e Prizrenit nuk ka mundur të marrë me shumë se një pikë në përballje me Vllazninë e Pozharanit (0-0).

## IPKO SUPERLIGA - Java e 21-të

Ballkani - Drita	2-0
Gjilani - Feronikeli	2-1
Trepça '89 - Llapi	1-2
Prishtina - Ferizaj	3-2

Të enjten takohen:

13:00 Drenica - Flamurtari  
13:00 Vushtrria - Dukagjini

## TABELA

1. Ballkani	21	44 pikë
2. Gjilani	21	41
3. Prishtina	21	41
4. Drita	21	40
5. Feronikeli	21	31
6. Llapi	21	31
7. Trepça '89	21	26
8. Flamurtari	20	25
9. Drenica	20	24
10. Ferizaj	21	22
11. Vushtrria	20	15
12. Dukagjini	20	9

## LIGA E PARË - Java e 19

Vllaznia (P) - Liria	0-0
Drenasi - Trepça	2-0
KEK-u - Vitia	1-0
Malisheva - Dardana	1-2
Ramiz Sadiku - Istogu	0-0
2 Korriku - Vëllaznimi	4-1
Besa - Arbëria	2-0
Onix - Ulpiana	1-0

## TABELA

1. Besa	19	37 pikë
2. Arbëria	19	33
3. Malisheva	19	30
4. Istogu	19	30
5. Onix	19	29
6. 2 Korriku	19	29
7. Dardana	19	29
8. Liria	19	28
9. Drenasi	19	27
10. KEK-u	19	27
11. Ulpiana	19	22
12. Trepça	19	22
13. Vllaznia (P)	19	20
14. Ramiz Sadiku	19	19
15. Vëllaznimi	19	17
16. Vitia	19	16

## SHKURT

### Zekiqi, lojtari i muajt shkurt

Samir Zekiqi është votuar basketbollisti i muajt shkurt nga tifozët në faqen zyrtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës në "Facebook". Basketbollisti Samir Zekiqi ishte shpallur MVP i Javës së 24-të në Superligën e Kosovës në basketboll, derisa në garë ishin edhe Dardan Berisha, MVP i javës së 25-të dhe Nigel Johnson, MVP i javës së 26. Në muajin shkurt janë zhvilluar vetëm tri xhiro (24, 25, 26) për shkak të zhvillimit të Final 8 dhe dy ndeshjeve të Kosovës. Zekiqi ka pasur një edicion mjaft të mirë deri më tani, duke qenë ndër lojtarët kryesor të Golden Eagle Yllit dhe është pjesë e Kosovës.

### Myers përforcon Ponte Prizrenin

KB Ponte Prizreni është përforcur me amerikanin Marcus Myers. Fundori 180 centimetra i gjatë te Ponte e zëvendëson Benjamin Nakwaaah që u largua dy ditë më parë. Myers së fundi ka qenë pjesë e klubit të elitës së Armenisë, Erebusi Yerevan. Luajti pesë ndeshje dhe me një mesatare prej 25.2 pikëve, 6 kërcimeve e 5.6 asistimeve. Ponte Prizreni pas 24 ndeshjeve zë vendin e pestë në Superligë me 13 fitore e 11 humbje.

### Silva 'lakmon' transferimin te Barça

Thiago Silva pritet të largohet nga Paris Saint-Germaini në fund të këtij sezoni. E përditshmja spanjolle "Mundo Deportivo" shkruan se mbrojtësi brazilian dëshiron kalimin në skuadrën e Barcelonës. Nëse realizohet ky transferim, atëherë ish-mbrojtësit të Milanit do t'i plotësohet ëndrra për të luajtur me yllin argjentinas Lionel Messi.

### Lazio planifikon rinovimin me Strakoshën me dyfishim page

Lazio është duke kaluar një nga sezonet më të mira në histori të klubit, teksa po rivalizon me Juventusin dhe Interin për titullin kampion. Një nga lojtarët më të mirë të lacialët deri në këtë moment të sezonit, është edhe portieri shqiptar Tomas Strakosha. Ky i fundit ka qenë vendimtar, ku me disa nga pritjet e tij i ka dhënë pikë skuadrës së tij. Për shkak të formës së mirë që Strakosha po kalon, te Lazio janë duke menduar për rinovimin e kontratës. Sipas "Tuttosport", portieri shqiptar që momentalisht ka një kontratë deri në 2022 do të ketë një zgjatje të kontratës dhe, gjithashtu, një dyfishim të pagës së tij, ku ai aktualisht fiton një milion euro në sezon.

## Saliu: Challandesi ka kontratë të vlefshme me Kosovën

PRISHTINË, 4 MARS - Në ditët e fundit ka pasur zëra se selektorit të Kosovës, Bernard Challandes, i ka skaduar kontrata dhe tashmë e ardhmja e tij është në pikëpyetje. Challandesi u prezantua si trajner i Përfaqësueses së Kosovës më 2 mars 2018 dhe kontrata e tij

ishite dyvjeçare, andaj rrjedhimisht u raportua se tekniku zviceran nuk ka më kontratë valide me 'Dardanët'. Sekretari gjeneral i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Saliu, i ka mohuar këto zëra, duke thënë se zvicerani ka kontratë të

vlefshme me Kosovën. "Jo jo, nuk janë të vërteta ato raportime. Trajneri ka kontratë të vlefshme deri në përfundimin e Kampionatit Evropian", ka thënë Saliu për "lajmi.net". I pyetur se a është duke u negociuar për rinovimin e kontratës, ai është

përgjigjur: "Po, kemi nisur takimet e para. Jemi në fazën fillestare, pastaj do të shohim". Challandesi ka rekord impresiv me Kosovën që prej ardhjes së tij. Në 20 ndeshje ai ka arritur 11 fitore, pesë barazime dhe katër humbje.



## 'Dardanet' fillojnë përgatitjet për sfidën ndaj Ruisë, besojnë në rezultat të favorshëm

PRISHTINË, 4 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave i ka nisur përgatitjet për ndeshjen kundër Ruisë që zhvillohet të premten në orën 18:00 në Wiesbaden të Gjermanisë. "Dardanet" nën drejtimin e përzgjedhëses Afërdita Fazlija dhe asistentëve të saj Veton Çitaku, Sanije Krasniqi e Besart Ismajli kanë kryer sot paradite stërvitjen e parë në Wiesbaden. Intensiteti dhe ngarkesa e kësaj stërvitje ishte më e vogël, duke pasur parasysh se lojtaret vinin nga udhëtimi i një dite më parë. Gjithsesi, forma e lojtareve duket e mirë dhe entuziazmi për të treguar më të mirën e tyre në këtë sfidë të vështirë është i madh. "Mendoj se do të jetë një lojë shumë e vështirë ngaqë të dyja ekipet synojnë fitoren. Nuk e njohim shumë kundërshtarin, por në bazë të asaj çfarë kemi parë shihet se ka cilësi. Sidoqoftë, vajzat tona janë të motivuara dhe kjo u vërejt edhe në stërvitjen e sotme ku atmosfera është shumë e mirë. Në dy



stërvitjet e ardhshme do të punojmë për t'u koordinuar sa më mirë dhe sigurisht se të premten do të angazhohemi maksimalisht dhe do ta japim më të mirën tonë", ka thënë Valentina Limani. Nga afër stërvitjen e ka ndjekur edhe anëtarja e KE të FFK-së, Vjollca Krasniqi. "Dardanet" do t'i vazhdojnë stërvitjet edhe në mbrëmje, teksa nesër do të jetë stërvitja finale, ku përzgjedhësja Fazlija do të vendosë për 11-shen e lojtareve me formën më të mirë me të cilat do t'u vihet përballë ruseve. "Stërvitja e parë

ka kaluar shumë mirë. Atmosfera brenda grupit është si gjithmonë në nivelin e duhur dhe po punojmë me përkushtim maksimal. Ne i njohim cilësitë e kundërshtarit, por asnjëherë nuk do ta respektojmë më shumë sesa duhet. Jemi shumë të motivuara dhe do ta japim maksimumin që të marrim pikë nga ky takim. Pres që në këtë përballje të vështirë me ruset ta kemi edhe përkrahjen e tifozëve, ngase dihet se numri i bashkatdhetarëve tanë në Gjermani është i madh", ka thënë Edona Kryeziu.

## Lakersat me ritmin e kampionit, fitojnë edhe Clippersat dhe Toronto

Los Anxhelos, 4 mars - Lakersat arritën një fitore të lehtë në takimin e radhës në NBA, duke mundur me rezultat 120-107 Philadelphian. Ndeshje me dy pamje, më e mirë për miqtë në pjesën e parë (Robinsoni 25 pikë). Në këtë pjesë erdh edhe përmbysja e kalifornianëve, me Davis (37 pikë e 13 rebounde) e Jamesi (22 pikë e 14 asistime). Surprizë ishte fitorja e Golden States, që mundi me shifrat 116-100 Denverin jashtë fushe. Wiggins dhe Paschall realizuan nga 22 pikët për Warriorsin,



ndërsa për Denverin mungoi lojtari lider. Fiton edhe skuadra kampion e Torontos, që mundi me rezultat 123-114 Phoenixin, ndeshje që u vendos në minutat e fundit në favor të ekipit kanadez. Siakam me 33 pikë, Lowry me 28 e Powell me 26 bënë dallimin për Toronton, që qëndron në ekipet elitë në

Lindje. Nuk zhgënjën ekipi i Clippersave, që mundi me rezultat 109-94 Oklahoman, ndeshje ku u dallua Leonardo me 25 pikë. Në sekondat e fundit fiton San Antonio, që mundi 104-103 Charlotten (Murray 21 pikë), ndërsa Brooklyn fitoi 129-120 ndaj Bostonit pas kohës shtesë (LeVert 51 pikë).

### SHKURT

#### Muriqi: Nuk pajtohem me kritikën, kualifikohem në finale

Vedat Muriqi shënoi në gjysmëfinale të Kupës së Turqisë ndaj Trabzonsporit, duke e çuar në 15 numrin e golave. Fenerbahçe pësoi humbje me rezultat 2-1 ndaj Trabzonsporit, ndërsa ishte Muriqi që ia mban gjallë skuadrës së tij gjasat për kalimin në finale. "Ne e dinim që do të ishte një ndeshje e ashpër. Meqenëse patëm ndeshje vajtje-ardhje, u futëm në fushë për ta marrë rezultatit pozitiv. Ne nuk jemi të kënaqur me një gol të shënuar, por do të ishte më mirë 2-1 se 2-0. Ky nuk është një avantazh, por nuk është as një disavantazh i madh. Shpresoj se do të shkojmë në finale në Kadıköy me mbështetjen e tifozëve tanë", ka thënë Muriqi. "Unë nuk shënova në katër ndeshje radhazi, por nuk pajtohem me kritikën se paraqitjet e mia ishin në rënie. I respektoj të gjithë, por unë mundohem të luaj lojën time, vazhdimisht të kontribuoj për ekipin. Nuk ka rëndësi nëse shënoj apo jo, thjesht duhet të kontribuoj për ekipin", ka shtuar Muriqi, i cili shprehet i lumtur se ka shënuar dy gola brenda tri ditëve.

#### Koeman: E refuzova Barçën për Holandën

Ronald Koeman ka thënë se ka refuzuar mundësinë për ta drejtuar Barcelonën, për të mbetur i fokusuar te Kombëtarja e Holandës. Koeman, i cili kaloi gjashtë sezone te Barcelona si lojtar, ka bërë me dije se i është ofruar posti i trajnerit për të zëvendësuar të shkarkuarin Ernesto Valverde. Barcelona, pas refuzimit të Koeman, ka zgjedhur ish-trajnerin e Real Betisit, Quique Setien. I pyetur nëse i është ofruar mundësia për t'i drejtuar gjigantët katalanë, Koeman është përgjigjur: "Po. Por unë thash 'jo', sepse jam me ekipin kombëtar".

#### Rakitiqi, mes Sevilës dhe Atletico

Ivan Rakitiqi me shumë mundësi do të largohet nga Barcelona në përfundim të këtij sezoni. Kroati pritet të qëndrojë në La Liga pavarësisht prej interesimit të Juventusit apo Interit për kartonin e tij. Pas Sevilës, që kërkon ta rikthejë në "Sanchez Pizujan", mesfushori pëlqehet shumë nga Atletico Madridi dhe, sipas asaj që shkruajnë mediat iberike, mes drejtuesve të klubit dhe përfaqësuesve të lojtarit kanë nisur bisedimet për të gjetur një marrëveshje. 31-vjeçari u bashkua me katalanasit në verën e vitit 2014 nga Sevilla për 18 milionë euro, ndërkohë që ai ka një kontratë që përfundon në qershor të vitit 2021.

#### Katër çiklistë përfundojnë në spital prej coronavirusit

Pas lajmit për mbylljen para kohe të Turit të Arabisë Saudite në çiklizëm (u zhvilluan 5 nga 7 etapa), organizatorët kanë bërë me dije se disa persona kanë përfunduar në spital, të prekur nga coronavirusi. Këta persona, ashtu sikurse të gjithë pjesëmarrësit në Tur (çiklistë, staf, media etj.) ishin mbajtur prej 5 ditësh të mbyllur në hotele, si një masë paraprake deri në marrjen e analizave. Sipas organizatorëve, pas përfundimit të analizave, 12 persona janë prekur nga coronavirusi: 6 italianë, 4 rusë, 1 gjerman dhe 1 kolumbian. Nga këta, 4 persona janë çiklistë (2 rusë, 1 italian e 1 kolumbian), ndërsa të tjerët janë staf. I prekur nga coronavirusi është një turist, që shoqëronte një nga ekipet pjesëmarrëse në Turin e Arabisë Saudite (UAE Tour). Mësohet se të 12 personat e prekur kanë qenë të gjithë në katin e katërt të hotelit ku ishin akomoduar dhe aktualisht janë në karantinë.

### REZULTATET

Charlotte - San Antonio	103-104
Boston - Brooklyn	120-129
New Orleans - Minnesota	134-139
Oklahoma - Clippers	94-109
Denver - Golden State	100-116
Phoenix - Toronto	114-123
Lakers - Philadelphia	120-107
Sacramento - Washington	133-126



**Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë**  
**Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë**

Në përputhje me funksionet dhe kompetencat e Bordit të Drejtorëve të përcaktuara me nenin 21 të ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet e plotësimet e ligjit nr. 04/L-111, nenit 8 ligjit Nr. 03/L-212 të Punës ,dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 . Vendimit të datës 27.02.2020, të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "AMBIENTI" SH.A. me datën 05.02.2020.shpall:

### KONKURS

Titulli i pozitës: **Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit**

**Për punet dhe detyrat i përgjigjet Bordit të Drejtorëve**

#### Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Të posedojë diplomë universitare- Fakulteti ekonomik, nga Fusha e Financave/kontabilitetit. (Ekonomist i diplomuar ose master në shkencën ekonomike);
- Të posedojë përvojë profesionale mbi (5) pesë vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Të ketë shkathhtësi kompjuterike, posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 nenit 13;
- Aftësi për komunikim dhe bashkëpunim me stafin dhe me të tjerët, si dhe aftësi organizative;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushton kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKF i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;

Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve

#### Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me aplikacionin të bashkëngjisin edhe këto dokumente;

- Biografinë (CV) e detajuar
- Diplomë Universitare
- Deklaratën nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson Kushtet e Kualifikimit dhe Përshtatshmërisë Profesionale sipas nenit 17.1(ii),17.2 pikat(d),(f),(j),(k),(l) dhe(iii).
- Letër motivimin
- Dëshmi që nuk është nën hetime dhe i dënuar

#### Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta punësimi, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 20.03.2020 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



**Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A .Pejë**  
**Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë**

**Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A .Pejë Shpall Konkurs publik për këto vende pune :**

### KONKURS

**Pozita: PUNËTORI FIZIKË- / NË MBLEDHJEN E HEDHURINAVE (6)**

Vendi i punës Istog (2 pozita)

Vendi i punës Pejë (4 pozita)

#### Puntori ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
2. Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
3. Pas zbrazjes së Kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efektive dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit dhe Eprorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

#### Kualifikimi:

- Shkolla e mesme-
- Të ketë përvojë punë.
- Aftësia të mirë komunikimi

**Pozita: VOZITËS-/ I AUTOMJETEVE PËR BARTJEN E HEDHURINAVE (3)**

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për vozitjen e sigurt, duke i respektuar rregullat e komunikacionit.
2. Kujdeset për higjienën dhe pastërtinë e automjetit, pas kryerjes së punës bënë larjen e automjetit.
3. Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga Kryepunëtori në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve
4. Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatën për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
5. Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të bënë ndreqje të vogla, si nderimin e gomës, pastrimin e filterit etj. të qëndroj pran automjetit në puntori dhe të ndihmoimekanikut ose gomistit.
6. Çdo mëngjez është i obliguar të kontrolloi sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në makinë.
7. Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtpërdrejt.
8. Për punën e vetë i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

#### Kualifikimi

- Përgatitje profesionale-voztësi kategorive "C"

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në bazë të dokumenteve të aplikimit do të ftohen për tu konsideruar.

Informata të përgjithshme :

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabart punësimi , inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve , pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme .

**Mënyra e Aplikimit:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 20.03.2020 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – GovernmentShërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerziteteska Bolnicka i Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)Spitali Përgjithshëm Ferizaj (SPF) - Opsta Bolnica Uroševac (OBU) - Hospital General  
Ferizaj (IGF)

Drejtorja e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së, si dhe aprovimin fizik të dt.03.03.2020 nga drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Me datë 04.03.2020 shpallë këtë:

**K O N K U R S**

<b>Institucioni :</b>	Spitali Përgjithshëm Ferizaj
<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Mjekë Specialist
<b>Kategoria funksionale/koefficienti:</b>	I1-659
<b>Nëpunësi mbikëqyrës:</b>	Shefi i repartit
<b>Kohëzgjatja:</b>	Për kohë të pacaktuar
<b>Numri referencës:</b>	1254/20

- **Specialist Neurolog një (1) pozitë**
- **Specialist Otorinolaringolog një (1) pozitë**

**Qëllimi kryesor i vendit të punës:**

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

**Përgjegjësit kryesorë të mjekut specialist:**

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, paisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkojnë lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnime profesionale,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitë profesionale dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

**Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, si dhe dokumentet e kerkuara, bazuar në specifikat e institucionit :**

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Leternjoftimi kopje
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta, si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat, kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave, dhe nuk janë të punësuar në sistemin publik shëndetësor.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Data e mbylljes së konkursit:** 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit të Spitalit Përgjithshëm të Ferizajt, rruga "Ramadan Rexhepi" p.n. Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Drejtori Ekzekutiv

Dr.Jeton Zeqiri



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – GovernmentShërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerziteteska Bolnicka i Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)Spitali Përgjithshëm Ferizaj( SPF) - Opsta Bolnica Uroševac(OBU) - Hospital General Ferizaj  
(IGF)

Direkcija Opšte bolnice u Oroševcu, na osnovu člana 8. Zakona o radu br.03 / L-212 i člana 4 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o uređivanju postupaka za takmičenje u javnom sektoru, kao i čl. 5 Uredbe br. 1003/2016 o radnim odnosima HUCSK-a, kao odobrenje od 03.03.2020 od strane generalnog direktora HUCSK-a. 04.03.2020. Najavite ovo:

**K O N K U R S**

<b>Institucija:</b>	Opšta bolnica Uroševac
<b>Naziv posla:</b>	Lekari specialista
<b>Funkcionalna kategorija / koefficient:</b>	H-659
<b>Nadzorni službenik:</b>	Šef odeljenja
<b>Trajanje:</b>	Neograničeno
<b>Referentni broj:</b>	1254/20
<b>Specijalistički neurolog jedan:</b>	(1) položaj
<b>Specijalista otorinolaringolog jedan:</b>	(1) položaj

**Glavna svrha posla:**

Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na osnovu njihovog profesionalnog nivoa

Glavne odgovornosti lekara specijaliste:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalim upravljačkim osobljem upravlja ljudskim resursima, opremom, objektima i zalihama do nivoa kojem pripada.
- Obezbeduje visoke standarde nege pacijenata.
- Ljubaznost, briga i poštovanje pacijenta i osoblja.
- Ljubaznost i profesionalna saradnja sa ostalim osobljem.
- Odgovarajući prijem, pregled i lečenje pacijenta.
- Redovno se registruje kroz medicinsku dokumentaciju (istorija bolesti, letak, protokol itd.) Pacijenta.
- Redovno posećuje pacijente primljene u zdravstvenu ustanovu.
- Zahtevi za dodatne konsultativne posete,
- Nadgleda izvršavanje svakodnevnih zadataka radnog osoblja.
- Daje stručna mišljenja o radu koji on / ona obavlja.
- Obavlja i druge dužnosti koje Supervizor zahteva za nesmetano odvijanje posla u ustanovi u kojoj je zaposlen.
- Obavlja određene zadatke kada je to potrebno u odnosu na usku specijalističku profesiju.
- odgovoran za razvijanje svog individualnog i kolektivnog nastavnog plana i programa na radnom mestu,
- angažuje radno osoblje u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- pruža i razvija programe i kurseve stručnog usavršavanja,
- Obavlja redovne revizije (inspekciju radnih mesta, opreme i inventara).
- Obezbeduje čisto i sigurno okruženje za sve
- Upravlja potrošnim materijalom i drugom opremom,
- Obezbeduje efikasan sistem komunikacije za sve unutar institucije,
- Razvija i izvršava profesionalne protokole lečenja pacijenata,
- učestvuje u stručnim naučno-istraživačkim studijama,
- Preduzeti mere za unapređenje upravljačkih kvaliteta stručne i kolektivne obuke u jedinici,
- Obavlja komplementarne dužnosti na osnovu svojih profesionalnih i menadžerskih kvalifikacija itd.
- pružanje kvalitetnih zdravstvenih usluga zasnovanih na profesionalnom nivou,
- Davanje pismenih i usmenih stručnih saveta o lečenju pacijenata i propisivanje dnevne terapije,
- utvrđuje redosled i plan kliničko-laboratorijskih pregleda,
- Naručite ambulanti rad u ambulantom okruženju i pregledajte ih i prihvatite ih.

**Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, kao i potrebni dokumenti, zasnovani na specifičnostima institucije:**

- Diploma Medicinskog fakulteta;
- Specijalistička licenca za dotičnu lemu;
- kopiraj ID
- Prednost će imati kandidati koji imaju specijalnu obuku, kao i dobro poznavanje funkcionisanja kosovskog zdravstvenog sistema;

Uslovi učešća u zapošljavanju: Svi kvalifikovani građani Republike Kosovo, koji su u potpunosti sposobni da deluju, imaju odgovarajuće obrazovanje, imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i nisu zaposleni u Republici Kosovo, mogu se prijaviti. sistem javnog zdravstva

**Postupci konkursa:** Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

**Datum zatvaranja konkursa:** 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Podnošenje prijave: prijave se primaju i dostavljaju kancelariji za osoblje Opšte bolnice Uroševac, ulica „Ramadan Rexhepi“ br.

Prijave podnete nakon završetka konkursa i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Izvršni direktor

Dr Jeton Zeqiri



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

**NËPUNËS I JASHTËM PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE**

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 01/2020

Kohëzgjatja e Kontratës: 60 (gjashtëdhjet) ditë pune për 1 (një) vitë kalendarik me mundësi vazhdimi edhe për një vit të tjetër

Lloji i kontratës: Kontratë për punë dhe detyra specifike

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Propozon, zhvillon dhe mbështet implementimin e politikave / strategjive për zhvillimin e sistemit të informimit të OMK-së;
- Menaxhon procesin e zhvillimit të Sistemit të Informimit të OMK-së duke përfshirë procesin e prokurimit të komponenteve softuerike dhe infrastrukturës harduerike;
- Koordinon procesin e implementimit të Sistemit të Informimit të OMK-së;
- Raporton tek Kryetari i OMK-së për përmbushjen e aktiviteteve nga plani vjetor i veprimtimit, arritjet, sfidat dhe problemet e paraqitura si dhe masat korrektuese që duhen të ndërmerren;
- Punon me OMK-në për projektet e Teknologjisë Informative;
- Planifikon afatet dhe resurset që nevojiten lidhur me projektet e IT-së;
- Qartëson dhe përpilon specifikat e sistemeve të OMK-së;
- Përcakton kërkesat softuerike, harduerike dhe ato të rrjetit të internetit të OMK-së;
- Analizon kërkesat e IT-së brenda OMK-së dhe jep këshilla objektive të pavarura në përdorimin e IT-së;
- Prezanton zgjidhje me raport të shkruar dhe verbal;
- Teston, instalon dhe monitoron sistemet e reja;
- Përgatit dokumentimin dhe prezanton raportet e progresit për OMK-në;
- Organizon trajnime lidhur me IT-në për përdoruesit dhe konsulentët e tjerë;
- Gjën zgjidhje për nevojat imediate të OMK-së në kuptim të automatizimeve të proceseve, migrimit të të dhënave dhe zhvillimit të veglave minore softuerike;
- Asiston stafin e OMK-së në mirëmbajtjen e web-faqes zyrtare të OMK-së;
- Koordinon bashkëpunimin me kontraktorët e jashtëm për shërbime të IT-së;

**Shkollimi i kërkuar:**

- Diplomë universiteti në fushën e teknologjisë së informacionit apo në drejtime të ngjashme;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në fushën e IT-së;
- Të paktën 3 vjet përvojë mbikëqyrëse të projekteve të IT-së;
- Aftësi për të përpiluar dokumente dhe raporte teknike;
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të shpjeguar çështje komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Nohje e gjuhës angleze;

**Detyrat specifike**

- Asiston në mbarëvajtjen e punëve me stafin e OMK-së për analizimin e proceseve të punës dhe përpilimit të BPM (business process mapping);
- Asiston në finalizimin dhe testimin e zgjidhjes së përkohshme softuerike për nevojat e OMK-së;

**Paraqitja e kërkesave:**

Inkurajohen të aplikojnë të gjithë kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e lartëcekura. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, [www.omk-rks.org](http://www.omk-rks.org) dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org)

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

**Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **04.03.2020** deri më **18.03.2020**.

Për informata shtesë mundë të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872 300** apo **038 / 544 872**.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Kombi Taxi” me pronar Xhevat Salihi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 70514346 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kombi Taxi”, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 70420490 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Kombi Taxi”, has come to the decision to quit its business: 70420490 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients  
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zuhul CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

**Shijo Pranverën me...**

Jaffa Champion Plus A+C+E Multifrukti

Taste of World Wide Brand!

Jaffa Champion



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

Fatlume Shabani

☎ 044 900 978 | 045 681 898  
 📍 Sallon Depilimi Lume's Details  
 📷 lumesdetails  
 📍 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.**

**Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978**

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 📞 +386 49 848 553


PRISHTINË

**Gjej PUNË**

• Lajme nga tregu i punës  
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Bahrije Hoti shpall të pavlefshme dëftesat e SHF kl (I- VIII) "Drenica" Polac.
- ▶ Berat Salih shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.
- ▶ Berat (Nexhat ) Rama shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMP "Qendra e Kompetencës" Skenderaj.
- ▶ DPH "Bare", shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 70038534.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.

# AUTOSHKOLLA RITMI

044 248 173  
045 626 123  
044 648 122

PRISHTINË

autoshkollaritmi@gmail.com



Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

**Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020**

